

RAPORT I VEÇANTË

Për problematikat e vërejtura në veprimtarinë e disa organeve të administratës publike, gjatë zbatimit të projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”

Qershor 2018

Përmbajtja:

1. Hyrje

2. Procesi i shpronësimit në zonën e Shkozës, me subjekt përfitues, Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH).

3. Ligji nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe ecuria e shpronësimeve në zonën e Shkozës.

4. Prishja e ndërtimeve në zonën e Shkozës, Tiranë, në zbatim të Projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës).

5. Situata e dëbimit me forcë.

6. Ndërtimet ekzistuese para Gushtit të vitit 1991, në zonën e Shkozës.

7. Konkluzione përfundimtare.

1. Hyrje:

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në Ligjin nr. 8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka promovimin, parandalimin e shkeljes dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje dhe të drejtën për strehim të përshtatshëm.

Bazuar në trajtimin e gjerë, që institucioni i Avokatit të Popullit i kushton problematikave të respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive nga media e shkruar, por edhe nga ankesa individuale të paraqitura në institucionin tone, jemi vënë në dijeni të zhvillimeve, që lidhen me zbatimin e projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (Loti III), (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”, si dhe për procedurat e filluara për prishjen e ndërtimeve ekzistuese me destinacion banimi, apo shpronësimin e subjekteve, të cilët kanë pronësi të paluajtëshme në zonën e Shkozës, Tiranë.

Efektivisht, ndërhyrjet për prishjen e këtyre ndërtimeve që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor të sipërcituar kanë filluar dhe disa banesa janë prishur, ndërkohë që pritet që, ndërhyrjet të vazhdojnë për të prishur një numër tjetër të konsiderueshëm banesash, duke lënë të pastrehë një numër të madh familjesh, të cilat prej vitesh jetojnë në këtë zonë të qytetit të Tiranës.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur 10 ankesa individuale, si dhe është filluar me inisiativë një rast, që lidhet me këtë problematikë. Ndër ankesat e paraqitura veçojmë një peticion të dërguar në muajin Qershor 2017, nga banorë të zonës së Shkozës, që preken nga zbatimi i projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (Loti III), (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”.

Ndërkohë, Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të mandatit dhe detyrës së tij funksionale për mbrojtjen e të drejtave, lirive apo interesave të ligjshëm të individëve ka iniciuar edhe kryesisht shqyrtimin e çështjes së prishjes të ndërtimeve në zonën e Shkozës, Tiranë, prej Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Si indikator për inicimin e kësaj çështjeje kryesisht prej Avokatit të Popullit kanë shërbyer informacionet e bëra publike prej disa mediave.

Nënvizojmë faktin se janë të pritshme në të ardhmen, ankesa nga subjekte të ndryshëm që, ose u janë prishur objektet informale në disponim, ose janë njoftuar nga ana e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), për prishjen e tyre.

Kjo problematikë vazhdon ende të jetë në dinamikën e saj, ndaj edhe konstatimet dhe konkluzionet e nxjerra në këtë raport vlejné për ecurinë në vazhdim të të gjithë procesit të zbatimit të projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (Loti III), (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”, deri në përfundimin e tij.

2. Procesi i shpronësimit në zonën e Shkozës, me subjekt përfitues, Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH).

Me fillimin e shqyrtimit të trajtimit të problematikës së zbatimit të projektit me interes publik “Unaza Lindore Tiranë (Loti III), (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”, janë dërguar një sërë kërkesash për informacion ndaj organeve dhe institucioneve shtetërore, të përfshira në këtë proces.

Në përgjigje të kërkesave tona zyrtare, me shkresën e ARRSH-së, nr. 6988/1 prot. datë 21.09.2017, jemi informuar se po vijonte puna në terren për evidentimin e pasurive që prekeshin nga zbatimi i këtij projekti dhe më pas do të vijohej me plotësimin dhe dërgimin për shqyrtim në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), të kërkesës për shpronësim (shtesë), ku do të trajtoheshin të gjitha pasuritë pronë private që do të përfitonin shpronësim bazuar në legjislacionin në fuqi.

Në këtë kuadër, për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje, i jemi ridrejtuar sërish ARRSH-së, me shkresën nr. K3/I24-6 prot, datë 12.10.2017, duke kërkuar dhënien e shpjegimeve dhe vënien në dispozicion të akteve që disponoheshin nga ana e tyre, lidhur me:

- a) veprimet dhe procedurat që ishin ndërmarrë deri në atë kohë nga ARRSH për evidentimin e pasurive të ligjshme, që prekeshin nga zbatimi i projektit me interes publik në zonën e Shkozës, Tiranë, shoqëruar edhe me relacionin respektiv për numrin e pasurive të evidentuara dhe statusin juridik të pasurive, si edhe kërkesën për shpronësim;
- b) faktin nëse ishte kryer tashmë kompensimi në vlerë të plotë, në favor të pronarëve të shpronësuar, bazuar në VKM nr. 557 datë 27.07.2016 “*Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që prekeshin nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (Loti III)”*”. Më konkretisht është kërkuar informacioni se, cilat subjekte ishin kompensuar, masën e kompensimit dhe kohën e kryerjes së këtyre procedurave;
- c) statusin juridik të pasurive, të llojit troje dhe banesa, të evidentuara nga grupi i punës, të cituar në shkresën zyrtare të ARRSH-së, me nr. 6988/1 prot, datë 21.09.2017, të cilat nuk janë përfshirë në VKM nr. 557 datë 27.07.2016, por që prekeshin nga zbatimi i projektit të sipërcituar;
- d) kopjet e akteve dhe shkresave të ARRSH-së, drejtuar organeve të tjera të administratës publike, si IKMT dhe ALUIZNI, në kuadër të zbatimit të projektit me interes publik;
- e) gjithçka tjetër që kishte të bënte me këtë çështje.

Ky informacion duhej të dërgohej nga ana e ARRSH-së, brenda datës 20.10.2017, duke i bashkëngjitur edhe dokumentacionin administrativ ligjor, që kishte lidhje me çështjen, me qëllim identifikimin sa më të shpejtë të problematikës së parashtruar.

Për shkak të mungesës së informacionit, Avokati i Popullit i është drejtuar me kërkesa të përsëritura për shpjegime ARRSH, me shkresat me nr. K3/I24-7 prot, datë 15.11.2017 dhe nr.K3/I24-8 prot, datë 26.12.2017.

Në përgjigje të këtyre shkresave, nga ana e ARRSH jemi informuar me shkresën me nr. 9053/2 prot, datë 23.12.2017, pjesërisht mbi veprimet dhe procedurat e ndjekura në këtë rast, por me mbi 2 muaj vonesë dhe në shkelje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 19, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Konkretisht, ARRSH-ja vijon të theksojë faktin se ka plotësuar dhe dërguar në MTI “Kërkesën për shpronësim” (shtesë), me nr. 1464 prot. datë 23.02.2017, në të cilën janë trajtuar pasuritë pronë private, “arë” dhe “truall”, të konfirmuar në vazhdim nga ana e Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive Paluajtëshme.

Në vijim është dorëzuar me shkresën me nr. 9053 datë 10.11.2017,¹ kërkesa për shpronësim pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjitikës (MIE), për 49 pasuri, përkatësisht të llojit “arë”, “truall”, “ndërtesë” dhe objekte biznesi, me vlerë totale 614 591 261.1 lekë.²

Po kështu informohemi se, janë bërë dy pagesa me vlerë 24 296 791 lekë, në zbatim të VKM nr. 557 datë 27.07.2016.³

ARRSH-ja thekson se kanë paraqitur dokumentat për kompensim sipas ligjit, vetëm 5 pronarë, me vlerë 20 716 102 lekë, për të cilët po vijon procedura për pagesë. Këto pagesa nuk janë kryer ende, *pasi ka mungesë fondesh*, për të cilat janë në pritje. **Ky justifikim i dhënë, sipas gjykimit tonë është i pambështetur në ligj, sepse sipas parashikimeve ligjore në fuqi, fondi i pagesave duhet siguruar para se të fillojë shpronësimi.**

Në kërkesat tona zyrtare të sipërcituara, është bërë me dije fakti se në rast të mungesës së informacionit dhe akteve të kërkuara sa më sipër, do të prezumohej se këto informacione dhe akte nuk disponoheshin nga ana e ARRSH-së, gjë që do të pasohej me veprime të metejshme ligjore nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit.

¹ Kjo shkresë rezulton të jetë dërguar pas Kërkesës së parë për shpjegime, dërguar ARRSH-së nga Avokati i Popullit, në të cilën kërkohet informacion mbi procedurat që kishte ndërmarrë ARRSH në Shkozë.

² Kjo shkresë është dërguar bashkëngjitur dhe administrohet tashmë nga ana jonë.

³ Në zbatim të VKM 557/20156, vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë “truall” dhe “pyll” është 253 220 184 (dyqind e pesëdhjetë e tre milionë e dyqind e njëzet mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh, dhe do të përballohej nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësime”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar. Megjithatë duhet theksuar se, zbatimi i këtij VKM nuk mund të kryhet pa një mbulim adekuat me fonde, pasi në të kundërt mund të jemi në kushtet e konsumimit të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”.

Duhet theksuar në këtë rast, fakti i zvarritjes së vënies në dispozicion të informacionit dhe akteve të kërkuara nga Avokati i Popullit, pasi ARRSH ka dërguar një sërë materialesh lidhur me çështjen, vetëm rreth 2 muaj pas kërkesës së parë të Avokatit të Popullit, për vënien në dispozicion të dosjes dhe informacionit respektiv, duke shkelur kështu detyrimin kushtetues dhe ligjor për informimin dhe bashkëpunim me Avokatin e Popullit, ndërkohë që banesat e personave janë prishur.

Kjo vonesë merr një rëndësi të veçantë, po të kihet parasysh fakti se në zonën në fjalë vazhdonin të kryheshin veprime për prishjen e banesave.

3. Ligji nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, dhe ecuria e shpronësimeve në zonën e Shkozës.

Në referencë të kuadrit ligjor në fuqi duhet theksuar fakti se, Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, krahas procedurave që duhet të ndiqen dhe afateve që duhen respektuar për shpronësimin për interes publik, parashikon edhe përfundimin e procedurave të kompensimit të subjekteve, pronat e të cilave preken nga zbatimi i projekteve për interesa publikë dhe më pas fillimin e punimeve, për të cilat kërkohet shpronësimi publik.

Në nenin 5 të këtij ligji, parashikohet se kur realizimi ose mbrojtja e interesave publike nuk mund të arrihet pa ushtruar të drejtat e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, ose të luajtshme pronë private, Këshilli i Ministrave, mbi kërkesën e subjektit kërkues në favor të të cilit bëhet shpronësimi, me propozim të ministrit kompetent sipas këtij ligji, vendos shpronësimin e këtyre pasurive. Fryma e ligjit është e qartë, kur shprehet se shpronësimi ushtrohet si proces për një interes publik dhe është zgjidhja e fundit, kur ky interes publik nuk mund të realizohet ose mbrohet në mënyrë tjetër dhe gjithmonë duhet të kryhet në respektim të plotë dhe në mënyrë strikte të procedurave të parashikuara në ligj.

Duke iu referuar shkresave zyrtare të ARRSH-së, dosja respektive është dërguar në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, më datë 23.02.2017, për t’u proceduar më tej me miratimin e një VKM- shtesë, për shpronësimin e banorëve të Shkozës. Ndërkohë është miratuar një VKM,⁴ e cila sipas qëndrimit të shprehur nga ARRSH-ja, ende nuk ka gjetur zbatim të plotë, pasi nuk janë shpronësuar të gjithë subjektet që janë parashikuar në të.

Për disa pasuri që preken nga ky projekt është miratuar VKM nr.557 datë 27.07.2016 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (Loti III)”. Ndërkohë që është duke u punuar për një “Kërkesë për shpronësim” shtesë, ku pritet të evidentohen pasuri të tjera,⁵ që preken nga zbatimi i këtij projekti dhe është kërkuar përfshirja e tyre në procesin e shpronësimit.

⁴ VKM nr. 557 datë 27.07.2016 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (loti 3)”.

⁵ Konkretisht janë 49 pasuri arë, truall, ndërtesë dhe objekte biznesi me vlerë totale 614 591 261.1 lekë.

Procedura shtesë për evidentimin e pasurive dhe plotësimin e dërgimin për shqyrtim në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës të kërkesës për shpronësim, është e pajustificuar dhe shumë problematike për situatën juridike të pronarëve që preken në pronësitë e tyre, ndërkohë që, në zonën e zbatimit të projektit është ndërhyrë nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Tiranë, për prishjen e disa objekteve.

Ndërkohë edhe pronarët që disponojnë dokumentacione të rregullta pronësie nuk kanë përfutuar akoma vlerën e shpronësimit, megjithëse Ligji nr. 8561 date 22.12.1999 “*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*”, i ndryshuar, parashikon domosdoshmërisht përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe më pas vijimin e zbatimit të projektit publik.

Vlen të theksohet se VKM nr. 557 datë 27.07.2016, bën fjalë vetëm për shpronësim të llojit të pasurisë “Arë” dhe “Pyje”, por jo të llojit “Ndërtesë”. **Pra, Këshilli i Ministrave ende nuk ka miratuar një vendim për shpronësimin e banorëve, banesat e të cilëve preken nga zbatimi i projektit të sipërcituar.** Ndërkohë nga informacionet më të fundit të marra mbi këtë çështje, rezulton se ende nuk është nxjerrë një Vendim i pritshëm nga ana e Këshillit të Ministrave, për shpronësimin e pasurive të tjera të evidentuara, të papërfshira në VKM nr. 557 datë 27.07.2016, të cilat preken nga zbatimi i projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (Loti III), (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri - Unaza e Jashtme e Tiranës)”. Në këto rrethana, situata ligjore e trajtimit të banorëve që disponojnë këto pasuri bëhet më e paqartë, ndërkohë që ka ndodhur edhe prishja e disa banesave në këto kushte, duke cënuar kështu të drejtat e pronësisë, të subjekteve posedues të tyre.

E drejta e pronës është e parashikuar dhe sanksionuar edhe në nenin 1, të Protokollit 1, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Në rastin konkret, kjo e drejtë mund të ndërthuret dhe interpretohet edhe me nenin 8, të KEDNJ, ku parashikohet se:

“Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”.

Në një mori vendimesh të Gjykatës së Strasburgut është bërë e qartë se, e drejta e strehimit përfshin edhe rastin e godinave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, ose që ju mungon dokumenti i pronësisë. Në një nga çështjet e shqyrtuara me këtë objekt vitet e fundit,⁶ Gjykata e Strasburgut konstatoi se, ankuesit kishin pësuar një shkelje të së drejtës së tyre për respektimin e jetës private, jetës familjare dhe shtëpisë (neni 8, i KEDNJ). Baza e konstatimit të Gjykatës ishte se, autoritetet shtetërore nuk shqyrtuan faktin nëse prishja e

⁶ Shih *Affaire Bagdonavicius et autres c. Russie*, (Requête n° 19841/06), Strasburg 11 tetor 2016.

shtëpive të ankuesve ishte në përputhje me parimin e proporcionalitetit, përpara se të vijonin me prishjen e banesave.

Në kuptim të legjislacionit në fuqi, objekte të shpronësimit janë pasuritë e paluajtshme në formën e tokës, të ndërtimeve të çdo lloji me karakter të përhershëm, si dhe pasuritë e luajtëshme të treguara në shkronjat "e" dhe "ë", të nenit 8, të Ligjit 8561/1999, i ndryshuar.

Shpronësimi mund të bëhet në favor të shtetit dhe të personave juridikë publikë, ose privatë, vendas ose të huaj, për realizimin nga ana e tyre të një projekti, investimi apo objekti që, në çdo rast në përputhje me këtë ligj, paraqet interes publik.

Subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë kompetente sipas ligjit, kërkesën për shpronësim, e cila duhet të shoqërohet me dokumentacion shtesë si: aktet që vërtetojnë cilësinë dhe regjistrimin e tij si person juridik; projektet e nevojshme dhe të miratuara sipas ligjit, si dhe argumentet përkatëse ligjore për interesin publik; dokumentacionin lidhur me burimin dhe garantimin e fondeve financiare të nevojshme për realizimin e projektit, duke përfshirë edhe ato të shpronësimit apo të zhvlerësimit; vlerësimin paraprak të objekteve të shpronësimit dhe i masës së shpërblimit që parashikohet për secilin pronar privat; lejet dhe miratimet përkatëse nga organet kompetente sipas ligjit; aktet që vërtetojnë mënyrën e realizimit të projektit, nga vetë kërkuesi i shpronësimit ose me të tretë, si dhe afatet përkatëse; listën e pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi, si dhe dokumentet që vërtetojnë shkakun e shpronësimit.

Ministria kompetente kryen verifikimet e nevojshme për subjektin kërkuar, në favor të të cilit kërkohet shpronësimi, për dokumentacionin e paraqitur, për shkakun e shpronësimit, si dhe administron aktet e pronësisë për objektet e shpronësimit, duke kryer nëse është e nevojshme edhe verifikime në vend.

Me njoftimin e kërkesës për shpronësim për interes publik, për të krijuar mundësitë për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave të tretë ndaj, ose për shkak të pasurive pronë private që kërkohet të shpronësohen, ministria kompetente bën publikimin e kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare, në një gazetë me shpërndarje në të gjithë vendin dhe në një gazetë vendore, për një periudhë një javore.

Ministri kompetent nuk mund të kërkojë në Këshillin e Ministrave, marrjen e vendimit të shpronësimit përpara një afati një mujor nga dita e përfundimit të procedurave dhe afateve të njoftimit të drejtpërdrejtë të pronarit që shpronësohet, dhe nga dita e publikimit të kërkesës për shpronësim, sipas këtij ligji.

Brenda 15 ditëve nga data e njoftimit sipas këtij ligji, ose të afatit të publikimit të kërkesës për shpronësim, pronari, bashkëpronarët, apo personat e tretë duhet të vënë në dijeni ministrinë kompetente, duke u shprehur edhe nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara prej saj.

Në vlerësimin e pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive të tjera që zhvlerësohen apo të të drejtave të të tretëve, që duhet të kompensohen për shkak të shpronësimit, sipas natyrës së tyre, merren parasysh vlera fillestare e tyre, amortizimi, destinacioni, vendndodhja e objektit, indekset e ndryshimit të çmimeve të tregut dhe të monedhës. Jepet kompensim për vlerën e zhvlerësimit të pronës në rastet kur shpronësimi për interes publik shoqërohet me zhvlerësimin e pjesës së pronës, që nuk është shpronësuar, ose të pronës që ndodhet pranë asaj që shpronësohet.

Me përfundimin e procedurave paraprake të shpronësimit, ministri kompetent i paraqet Këshillit të Ministrave propozimin për shpronësim, të shoqëruar me dokumentacione si: Relacionin përmbledhës për qëllimin, shkakun dhe nevojën e shpronësimit, për afatin e fillimit dhe të mbarimit të shpronësimit, si dhe për afatin e fillimit e të përfundimit të punimeve ose të realizimit të qëllimit të shpronësimit; Listën përfundimtare të pronarëve të pasurive që shpronësohen ose që zhvlerësohen dhe aktet përkatëse të pronësisë; Dokumentacionin e vlerësimit të pasurive që shpronësohen e zhvlerësohen, i të drejtave të të tretëve që lidhen me to dhe i masës së shpërblimit, apo kompensimit të propozuar me argumentet përkatëse, si edhe dokumentet që vërtetojnë shpenzimet e procedurës së shpronësimit.

Këshilli i Ministrave vendos shpronësimin në rastet kur, propozimi për shpronësim gjendet i bazuar në ligj dhe në fakt. Vendimi i shpronësimit duhet të përmbajë; Qëllimin dhe shkakun ligjor të shpronësimit; pasuritë prone private që shpronësohen dhe pronarët përkatës; masën e shpërblimit për pronarët që shpronësohen, për pronarët e pasurive që zhvlerësohen, për personat e tretë që kompensohen për të drejtat e tyre për shkak të pronësimit, si dhe afatin dhe mënyrën e pagimit të tyre; afatin e fillimit dhe të mbarimit të shpronësimit, si dhe organin ose subjektin që merr në përdorim pasuritë prone private të shpronësuar; afatin e fillimit dhe të përfundimit të punimeve për projektin dhe investimin ose për realizimin e qëllimit të shpronësimit; vlerën e shpenzimeve të procedurës së shpronësimit në ngarkim të kërkuesit të shpronësimit.⁷

Sikurse rezulton, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM nr.557 datë 27.07.2016 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (Loti III)”. Nisur nga kriteret ligjore të sipërcituara për përmbajtjen e këtyre akteve, që nxirren nga ana e Këshillit të Ministrave në rast shpronësimi për interes publik, konstatohet se VKM nr.557 datë 27.07.2016, nuk përcakton shprehimisht afatin dhe mënyrën e pagimit për pronarët që shpronësohen, për pronarët e pasurive që zhvlerësohen, për personat e tretë që kompensohen për të drejtat e tyre për shkak të pronësimit. Po kështu, ky VKM nuk përcakton shprehimisht, afatin e fillimit dhe të mbarimit të shpronësimit, si dhe afatin e fillimit dhe të përfundimit të punimeve për projektin dhe investimin, ose për realizimin e qëllimit të shpronësimit.

⁷ Shih nenin 21, të Ligjit nr. 8561 date 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar.

Masa e shpërblimit u jepet ose u vihet në dispozicion, përkatësisht, të shpronësuarit, pronarit apo personit të tretë të dëmtuar, brenda afatit të treguar në shkronjën "c", të nenit 21, të ligjit dhe në çdo rast, jo më vonë se 3 muaj nga mbarimi i këtij afati, ose nga data që ka marrë formë të prerë vendimi i gjykatës, sipas pikës 2, të nenit 16, dhe nenit 24, të Ligjit 8561/1999, i ndryshuar.

Lidhur me pavlefshmërinë e procesit të shpronësimit për interes publik, pika 3, e nenit 26, të Ligjit 8561/1999, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Shpronësimi quhet i pavlefshëm në rast se brenda afateve të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji nuk është kryer pagesa ose vënia në dispozicion e masës së shpërblimit, sipas këtij ligji, për llogari të pronarëve të shpronësuar, si dhe të pronarëve e personave të tretë të dëmtuar për shkak të shpronësimit.”

Në këtë kuadër, duke patur parasysh faktin se ka zvarritje të procedurave të kompensimit të banorëve për efekt të shpronësimit dhe verifikime të tjera shtesë të pasurive që preken nga zbatimi i projektit, kjo procedurë shpronësimi bëhet e pavlefshme në kuptim të dispozitës së sipërcituar. Kjo pavlefshmëri mund të vlerësohet edhe në kuadër të përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 26, të Ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar.

Në këtë kuadër, vlen të përmëndim faktin se nisur nga ky rast, por dhe nga praktika të tjera të marra në shqyrtim nga ana e Avokatit të Popullit, me objekt shpronësimit për interesa publik, kemi konstatuar se përpara fillimit të procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të subjekteve, fillohet me punimet publike, duke përbërë dhe evidentuar në këtë mënyrë, cënim të të drejtave të pronësisë së pronarëve.

Veprimet dhe mosveprimet e strukturave shtetërore janë bërë shkak që të zvarritet kompensimi në vlerën e shpronësimit për një kohë të gjatë, nga data e miratimit të VKM-ve respektive, duke iu cënuar pronarëve kështu në vazhdimësi të drejtat themelore të parashikuara në nenin 41 dhe 42, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Konkretisht, në nenin 41/4, të Kushtetutës thuhet shprehimisht se: *“...Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë”*.

Përveç kësaj, vonesa e krijuar në likuidimin e subjekteve të shpronësuar, mund të interpretohet ligjërisht edhe në formën e dëmit të shkaktuar dhe fitimit të munguar mbi të drejtat që rrjedhin nga pronësia e subjekteve, në rast se ata do t'i drejtohen gjykatës, referuar nenit 44, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilën parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”*.

E drejta e shtetasve për shpronësim, parashikohet edhe në Nenin 1, të Protokollit 1, të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut, ku ndër të tjera thuhet se: *“Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”*.

Avokati i Popullit, bazuar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, konkretisht në nenin 3, të tij, ku thuhet se:

“Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore”,

thekson faktin se, **mënyra e garantimit dhe mbrojtjes të së drejtave të pronësisë të shtetasve që shpronësohen, duhet të zhvillohet përmes një procedure të rregullt ligjore shpronësimi, duke patur parasysh likuidimin e plotë për vlerën e shpronësimit të subjektit, si edhe përcaktimin e një afati përmbyllës së këtij procesi brenda një kohë sa më të shkurtër dhe të arsyeshme, si pjesë e një procesi të rregullt administrativ.** Pagesa e dëmshpërblimit mund t’i nënshtrohet shtyrjeve ose mënyrës së pagimit me këste, por në asnjë rast personat nuk duhet dhe nuk mund të humbasin të drejtën e gëzimit të sendit, pa marrë plotësisht pagesën e dëmshpërblimit.

4. Prishja e ndërtimeve në zonën e Shkozës, Tiranë, në zbatim të Projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës).

Në datën 14.09.2017, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit, kanë qenë prezent në tubimin e kryer prej banorëve të zonës së Shkozës, Tiranë, në të cilin janë shfaqur kundërshti ndaj veprimeve të nisura prej IKMT-së, për prishjen e ndërtimeve në këtë zonë.

Në tubimin e zhvilluar në këtë datë është vërejtuar një situatë e tensionuar midis banorëve të grumbulluar dhe forcave të Policisë së Shtetit. Një numër banorësh janë larguar dhe shoqëruar forcërisht prej këtyre forcave, për në ambjentet e Komisariateve të Policisë së Shtetit, me qëllim normalizimin e situatës dhe lejimin e lëvizshmërisë normale në rrugën automobilistike.

Situata e konstatuar ka shërbyer për regjistrimin e kësaj çështjeje me iniciativë për shqyrtim të mëtejshëm të saj. Vijueshmërisht është monitoruar prej përfaqësuesve të Institucionit të Avokatit të Popullit, veprimtaria e IKMT-së, për prishjen e ndërtimeve në zonën e Shkozës, Tiranë, duke marrë dhe pranuar njëkohësisht për shqyrtim disa ankesa individuale të banorëve të zonës, ndërtimet e të cilëve u bënë objekt prishjeje nga ana e këtij organi.



Për verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë të nisur prej IKMT-së, për prishjen e ndërtimeve në zonën e Shkozës, institucioni i Avokatit të Popullit, i është drejtuar zyrtarisht disa organeve dhe institucioneve shtetërore për dhënie informacioni, apo shpjegimesh.

1. Me shkresën nr.K3/I39-3 prot, datë 15.09.2017, i është kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, informacion rreth subjekteve, të cilët kanë vetëdeklaruar ndërtime informale për legalizim në zonën e Shkozës, Tiranë, si dhe vënien në dispozicion të akteve zyrtare të nxjerra, për secilin subjekt vetëdeklarues.

Në mënyrë të cunuar është dhënë informacion prej ALUIZNI-t, për ndërtimet të cilat janë skualifikuar për legalizim, në zbatim të Projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës). Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, është mjaftuar vetëm me vënien në dispozicion, të vendimeve për skualifikimin e ndërtimeve nga procesi i legalizimit, si dhe njoftimeve zyrtare të dërguara secilit person.

Pavarësisht kërkesave tona, nuk na është vënë në dispozicion tërësia e të gjithë akteve të administruara prej ALUIZNI-t, në dosjet e veçanta të krijuara mbi bazë të vetëdeklarimeve të kryera prej cilitdo prej subjekteve të prekur, nga zbatimi i Projektit.

Në shkresën e ALUIZNI-t me nr.7005/5 prot, datë 07.11.2017, drejtuar Avokatit të Popullit, pretendohet se është mundësuar vënia në dispozicion e kopjeve të shkresave nr.

2308 prot, datë 24.03.2017, që ARSSH-ja i ka drejtuar ALUIZNI-t, si dhe nr. 2270/2 prot, datë 31.07.2017, që IKMT-ja i ka dërguar ALUIZNI-t, por detyrimi ligjor i dhënies së informacionit të kërkuar nuk është përmbushur në këtë rast.

2. Me shkresën nr.K3/I39-2 prot, datë 15.09.2017, i është kërkuar Kryeinspektorit të IKMT-së, vënia në dispozicion e të gjithë akteve zyrtare të nxjerra për secilin subjekt, ndërtimet e të cilëve janë përcaktuar si objekte për prishje prej IKMT-së, në zonën e Shkozës, Tiranë.

Kryeinspektori i IKMT-së, në përgjigje të kërkesës së Avokatit të Popullit, me shkresën nr.3498/3 prot, datë 25.09.2017, na ka bërë të ditur se, veprimet për prishjen e ndërtimeve janë në mbështetje të kërkesës së Autoritetit Rrugor Shqiptar, drejtuar me shkresën nr.5736, datë 12.07.2017, ku kërkohet lirimi i sheshit të ndërtimit.

Në vazhdim, Kryeinspektori i IKMT-së, ka mundur vënien në dispozicion të akteve zyrtare të nxjerra vetëm për një kundërvajtës në këtë zonë, ndërtimi i të cilit është bërë objekt prishjeje, në datën 20.09.2017. Ky informacion nuk na është dërguar për të gjithë subjektet e prekur në pronësitë e tyre nga zbatimi i projektit, sikurse i është rikërkuar edhe në një takim të zhvilluar në ambientet e IKMT-së, Kryeinspektorit të këtij organi publik, nga drejtuesit e institucionit të Avokatit të Popullit, për shkak të moskthimit të përgjigjes.

Ndodhur në këto kushte i jemi ridrejtuar Kryeinspektorit të IKMT-së, me shkresat nr.I39-12 prot, datë 02.10. 2017, dhe nr.I39-13 prot, datë 12.10.2017, duke përsëritur kërkesën për vënien në dispozicion të të gjithë akteve zyrtare të nxjerra për secilin individ, ndërtimi i të cilit është konstatuar dhe sanksionuar me vendim prishjeje prej IKMT-së, në funksion të lirimimit të sheshit të ndërtimit, në zbatim të Projektit, “*Unaza e Jashtme e Tiranës*”, *Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)*. Pas më shumë se një muaji nga data e kërimit, Kryeinspektori i IKMT, me shkresën nr. 3911/1 prot, datë 18.10.2017, ka mundur vënien në dispozicion të akteve të nxjerra për 50 subjekte, nga të cilat, 43 prej tyre janë sanksionuar me vendim për prishje objekti.

- *Shqyrtimi i disa ankesave për ndërhyrjen e IKMT-së, për prishjen e disa ndërtimeve në zonën e Shkozës:*

Sikurse është thënë në fillim të përmbajtjes së këtij raporti, individë të caktuar janë ankuar për prishjen e banesave të tyre, nga ana e IKMT-së, për shkak të fillimit të punimeve për zbatimin e projektit “*Unaza e Jashtme e Tiranës*”, *Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)*. Më poshtë po paraqesim dy prej tyre:

Në ankesën e tij shtetasi H.K., shkruan se, në datën 26.10.2017, i është prishur shtëpia ku banonte nga ana e inspektorëve të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), dega Tiranë.

Kjo banesë ishte ndërtuar në vitin 1992 dhe ishte vetëdeklaruar për legalizim, që në vitin 2005. Megjithatë, ankuesi shprehej se në datën 26.10.2017, inspektorë të IKMT dega Tiranë, kanë shkuar dhe i kanë njoftuar vendimin e prishjes së banesës, vetëm 2-3 orë para se objekti në fjalë të prishej.



Duke u gjendur në befasi ankuesi është shprehur në ankesë se, veprimi i menjëhershëm i inspektorëve të IKMT dega Tiranë, ka bërë që ai të mos mund të nxjerrë jashtë banesës as edhe sendet shtëpiake dhe mobiljet, gjë që ka sjellë shkatërrimin e tyre së bashku me banesën. Ndaj ai ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, për zgjidhjen e çështjes së demit që atij i është shkaktuar në këtë rast.

Nga informacioni i marrë prej Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana Jug dhe IKMT dega Tiranë, na janë vënë në dispozicion këto kopje të shkresave zyrtare, që lidhen me trajtimin e kësaj çështjeje:

1. Shkresa nr.3283 datë 31.08.2017, e Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana Jug, drejtuar z. H.K dhe për dijeni Kryeinspektorit të IKMT-së, dhe Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.
2. Urdhëri nr.82 datë 8.09.2017, i Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana Jug, për përjashtimin nga procesi i legalizimit të objektit të vetëdeklaruar me nr.572 prot, datë // 2005, nga z. H.K.
3. Proces verbal për konstatimin e kundërvatjes nr.7 datë 14.09.2017, ku subjekti i kontrolluar “H.K”, rezulton “jo prezent”, megjithëse në një rubrikë tjetër të po këtij dokumenti thuhet se, subjekti i kontrolluar “nuk pranon të nënshkruajë”.
4. Vendim për dënim me gjobë nr.1 datë 19.09.2017, ndaj kundërvjatësit H. K.
5. Shkresa e IKMT dega Tiranë, nr.480/3 datë 19.09.2017, “Njoftim vendimi (nr.1 datë 19.09.2017)”, drejtuar shtetasit H.K.

6. Vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.29 datë 19.09.2017, ndaj kundërvajtësit H.K.
7. Shkresa nr.480/2 datë 19.09.2017 e IKMT dega Tiranë, “Njoftim vendimi (nr.29 datë 19.08.2017)”, drejtuar shtetasit H.K. Në këtë shkresë bie në sy fakti se, në fund të saj kanë nënshkruar në njërin krah inspektorë të IKMT, dega Tiranë dhe në krahun tjetër në rubrikën, “Subjekti kundërvajtës, Prezent”, është vënë shënimi se, “Nuk pranon firmën”. Ndërkohë rubrika tjetër e po të njëjtit dokument, “Data dhe ora e njoftimit”, janë të paplotësuara.
8. Proces verbal (IKMT) ekzekutimi i mbajtur në datë 26.09.2017, për ekzekutimin e vendimit nr.29 datë 19.09.2017, nr.serie 0001380.

Kemi kërkuar nga IKMT dega Tiranë, me shkresën tonë nr.K3/H19-5 datë 5.12.2017, sqarimin e procedurës zyrtare të ndjekur me anë të së cilës shtetasi H.K, ka marrë dijeni për, Vendimin për dënim me gjobë nr.1 datë 19.09.2017, dhe Vendimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.29 datë 19.09.2017. Më konkretisht kemi kërkuar shpjegime, nëse ato i janë dërguar atij me anë të postës, apo në një rrugë tjetër njoftimi zyrtar. Për këtë gjë kemi kërkuar të na dërgohet edhe një kopje e dokumenteve zyrtare, që vërtetojnë këtë dërgesë në rastin e njoftimit me postë, apo në rast njoftimi me mënyra të tjera ligjore, dërgimin e dokumentacionit respektiv zyrtar, që vërteton ezaurimin e kësaj procedure njoftimi të ndjekur.

Në përgjigjen e IKMT Tiranë dhënë me shkresën nr.4733/1 datë 22.12.2017, thuhet se: *“Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për rastin në fjalë ka bërë njoftimin zyrtar me anë të postës, e cila për shkak të ndryshimit të adresës së qytetarit është kthyer mbrapsht. Në vijim, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, për njoftimin e qytetarit të këtyre akteve, me shkresën nr.665 prot, datë 7.12.2017, me lëndë “Njoftim për shpallje”, i është dërguar Njesisë Administrative nr.1, Bashkia Tiranë, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme”.*

Bashkëngjitur kësaj shkrese janë dërguar edhe një kopje e dokumenteve zyrtare:

- Shkresa e IKMT dega Tiranë, nr.615 datë 7.12.2017, “Njoftim për shpallje”, sipas përmbajtjes të së cilës, në zbatim të nenit 60, pika “ç”, e Kodit të Procedurave Administrative, i janë dërguar për afishim në vend publik Njesisë Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë, disa vendime për dënim me gjobë, mes të cilëve edhe “Vendim për Dënimin me Gjobë Nr.01 datë 19.09.2017, me nr.serie 0001021, ndaj subjektit H.K.
- Vërtetim zyrtar i Postës Shqiptare, me kod RR 751 228 737 AL, me objekt nr.480/3 (Vendimi i dënimit me gjobë), me shënimin “ka ndryshuar adresë”. Ky vërtetim mban datën 5.10.2017.

Legjislacioni në fuqi për trajtimin e kësaj çështjeje nga ana e IKMT-së, përcakton shprehimisht:

**Ligji nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar:*

- “Kontrolli i Territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga,

- b) Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit” (neni 3/b).
- “Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet kryeinspektorit dhe inspektorëve, ushtron këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) Ushtron përgjegjësitë e veta në nivel njësie vendore drejtëpërdrejt dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor” (neni 9/a).
 - Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, përveç detyrave të tjera, të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë që:
 - a) Të ushtrojë përgjegjësitë e veta të njësisë vendore, sipas nenit 5, të këtij ligji, për ndërtime/punime të kundërligjshme në territorin e njësisë vendore, që nuk përfshihen në çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor” (neni 9/1, pika 1/a e plotësuar për zbatimin e saj me parashikimet e pikës 2, 3 dhe 4 të këtij neni).
 - “Për ushtrimin e përgjegjësive dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore kryejnë inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë, ose me një grup inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të IKMT-së dhe një inspektor të njësisë vendore.
- Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës të konstatimit dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu edhe nga subjekti i kontrolluar ose përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë, një kopje e proces verbalit i jepet subjektit të kontrolluar.
- Kur subjekti i kontrolluar nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin ose nuk është i pranishëm, ky fakt pasqyrohet në proces verbal dhe nënshkruhet nga grupi i inspektimit. Kur subjekti nuk është i pranishëm, i jepet një kopje e proces verbalit brenda 5 ditëve nga data e kontrollit”, (neni 12, pika 1, pika 5 dhe pika 6).
- “Brenda 10 ditëve nga mbajtja e proces verbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë së qeverisjes vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori” (neni 13, paragrafi i parë).

**Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”:*

- “1. Organi publik i komunikon palës ose një subjekti tjetër, të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit.
- 1. Në çdo rast, organi publik kryen njoftimin, duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston” (neni 147, pika 1 dhe pika 3).
- “Njoftimi publik bëhet në këto raste:
 - b. Kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151, të këtij Kodi,
 - c. kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatëshme apo e pamundur” (neni 162, pika 1, gërma “b” dhe “c”).

Në trajtimin që i është bërë kësaj çështjeje, është konstatuar se IKMT dega Tiranë, në ushtrim të kompetencave të veta ka nxjerrë dy akte administrative, përkatësisht, Vendimin për dënim me gjobë nr.1 datë 19.09.2017, dhe Vendimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.29 datë 19.09.2017, ndaj kundërvajtësit H.K.

Koha e njoftimit të aktit administrativ (përkatësisht i dy vendimeve të sipërcituara), si një pjesë shumë e rëndësishme e procedurës ligjore që duhet ndjekur nga ana e organit të administratës publike, për mundësimin e fillimit të efekteve dhe pasojave juridike të aktit administrativ të nxjerrë nga ky organ është edhe analiza që është kryer nga ana jonë për përcaktimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e IKMT-së. Kjo pjesë lidhet edhe me pretendimin kryesor të parashtruar nga ana e shtetasit H.K në ankesën e tij, drejtuar Avokatit të Popullit.

Më konkretisht, në pikën 1, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, thuhet se: *“Një akt administrativ fillon të sjellë pasoja juridike ndaj palës së cilës i drejtohet apo interesat e së cilës preken nga akti, me njoftimin e përmbajtjes së aktit palëve”*. Në logjikën dhe rregullimet përkatëse të legjislacionit në fuqi, evidentohet paraprakisht se:

-Procedura e ndjekur për njoftimin e Vendimit për dënim me gjobë nr.1 datë 19.09.2017, sikurse rezulton nga dokumentacioni i dërguar nga ana e IKMT dega Tiranë, është bërë sipas gërmave “b” dhe “c”, të nenit 162, të Kodit të Procedurave Administrative, (dhe jo sipas nenit 60, pika “ç”, e Kodit të Procedurave Administrative, të cituar në shkresën e IKMT dega Tiranë, nr.615 datë 7.12.2017). Për më tepër, sipas vërtetimit postar ky vendim i është dërguar për njoftim shtetasit H.K në datën 5.10.2017, kur objekti banesë ku jetonte ky shtetas është prishur në datë 26.09.2017. Pra, absurditeti dhe kundërligjshmëria në këtë njoftim qëndron në faktin se, shtetasi H.K është njoftuar me postë nga ana e IKMT-së, për Vendimin për dënim me gjobë me nr.1 datë 19.09.2017, në adresën e banesës së tij, që rezulton të jetë prishur 9 ditë para se të dërgohej ky njoftim. Është jashtë logjikës të mendosh se, shtetasi H.K pas prishjes së banesës së tij, do të vazhdonte të jetonte aty në rrënoja, në mënyrë që adresa e këtij ndërtimi tashmë inekzistent të mund të përdorej për njoftime të akteve të nxjerra prej IKMT-së.

-Procedura e njoftimit të Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.29 datë 19.09.2017, ka rezultuar jo në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Më konkretisht ka rezultuar se, me shkresën nr.480/2 datë 19.09.2017, “Njoftim vendimi (nr.29 datë 19.09.2017)”, IKMT dega Tiranë, ka kryer njoftimin për shtetasin H.K. Në këtë shkresë bie në sy fakti se, në fund të saj kanë nënshkruar në njërin krah, inspektorë të IKMT, dega Tiranë dhe në krahun tjetër në rubrikën “Subjekti kundërvajtës, Prezent”, është vënë shënimi se, “Nuk pranon firmën”. Ndërkohë rubrika e këtij dokumenti zyrtar, “Data dhe ora e njoftimit”, rezultojnë të paplotësuara. Kjo formë njoftimi, për nga mënyra e hartimit të përmbajtjes së shkresës nr.480/2 datë 19.09.2017, për afro me parashikimet e bëra në nenin 159, të Kodit të Procedurave Administrative, “Dorëzimi personalisht”, por ka dështuar të ezaurohet sipas këtyre përcaktimeve dhe ka mangësi të theksuara të përmbushjes dhe ndjekjes së procedurave, siç përcaktohet në këtë nen.⁸

⁸ Në nenin 159, të Kodit të Procedurave Administrative, parashikohet se:

“1. Njëpunësi i organit publik i dorëzon personalisht shkresën marrësit në një nga vendet e njoftimit të parashikuara nga ky Kod. Dorëzimi personalisht pasqyrohet në një procesverbal. Procesverbali përfshin të dhënat për identifikimin e shkresës së dorëzuar, datën e dorëzimit dhe nënshkruhet nga njëpunësi dhe marrësi.

Në shkresën nr.480/2 datë 19.09.2017, përveç faktit se kemi nënshkrimin e inspektorëve të IKMT, dega Tiranë dhe se, shkresa mban shënimin në rubrikën “Subjekti kundërvajtës, prezent”, “*Nuk pranon firmën*”, konstatohet se mungojnë elementët formalë që e bëjnë të vlefshëm njoftimin. Njëkohësisht në këtë logjikë, nuk janë plotësuar kërkesat dhe afatet proceduriale të dorëzimit personalisht të Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.29 datë 19.09.2017.

Edhe në përmbajtjen e proces verbalit për konstatimin e kundërvajtjes, nr.7 datë 14.09.2017, ku subjekti i kontrolluar është shtetasi H.K, ky shtetas rezulton “jo prezent”, në momentin e konstatimit në vend, megjithëse në një rubrikë tjetër të po këtij dokumenti thuhet se, subjekti i kontrolluar “nuk pranon të nënshkruajë”. Në të dyja rastet edhe kur subjekti i kontrolluar nuk është prezent edhe kur ai është prezent por nuk pranon të firmosë proces verbalin, (raste këto që kundërshtojnë ndodhshmërinë e mundshme njëkohësisht), është parashikuar shprehimisht në pikat 6 dhe 7, të nenit 12, të Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, mënyra se si do të njoftohet subjekti i kontrolluar për rezultatin e kontrollit të dhënë në përmbajtjen e proces verbalit përkatës. Nga përmbajtja e proces verbalit nr.7 datë 14.09.2017, nuk del e qartë nëse shtetasi H.K ka qenë prezent, dhe nëse po, a ka refuzuar të nënshkruajë proces verbalin, apo jo?

Nga informacioni që na është vënë në dispozicion, konsiderojmë se procedura e njoftimit të proces verbalit të konstatimit të kundërvajtjes, nr.7 datë 14.09.2017, është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore proceduriale të detyrueshme për njoftimin.

Përkundër kësaj problematike të konstatuar në përmbajtjen e akteve proceduriale të njoftimit, kemi pretendimin e shtetasit H.K se, inspektorë të IKMT Tiranë, kanë shkuar dhe i kanë njoftuar vendimin e prishjes së banesës, vetëm 2-3 orë para se objekti në fjalë të prishej. Pra, sipas tij, inspektorët e IKMT Tiranë, e kanë bërë fakt prishjen e objektit para se të ezauronin procedurën normale të njoftimit, të Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.29 datë 19.09.2017.

Në këto rrethana, barra e provës për njoftimin, qoftë të proces verbalit të konstatimit të kundërvajtjes, nr.7 datë 14.09.2017, apo edhe të Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.29 datë 19.09.2017, bie mbi organin e IKMT-së.

2. Nëse marrësi nuk gjendet në vendin e njoftimit, nëpunësi i organit publik bën një përpjekje të dytë për dorëzimin personalisht, jo më parë se 24 orë dhe jo më vonë se 72 orë nga përpjekja e parë.

3. Kur marrësi nuk gjendet përsëri apo kur ai refuzon marrjen në dorëzim, nëpunësi bën shënimin përkatës në një procesverbal dhe kur është e mundur e vërteton situatën me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Në këtë rast, nëpunësi i organit publik vendos një shënim në mjediset e vendit të njoftimit, duke përcaktuar marrësin dhe zyrën përkatëse në organin publik ku mund të tërhiqet shkresa. Në shënim përcaktohet data dhe ora e lënies së shënimit, dhe data që vlerësohet si data e kryerjes së njoftimit sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni.

4. Dorëzimi, sipas pikës 3, të këtij neni, vlerësohet i kryer pas 3 ditëve nga data e vendosjes së shënimit.

5. Dorëzimi bëhet vetëm gjatë ditëve të punës, nga ora 7.00'' deri në 19.00''''.

A janë njoftuar këto akte në përputhje me parashikimet ligjore nga ana e IKMT dega Tiranë? Kur i është njoftuar zyrtarisht Vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.29 datë 19.09.2017, z. H.K. në datën 19.09.2017, apo në datën 26.10.2017 dhe në çfarë ore? Nga shpjegimet e dhëna dhe kopja e dokumentacionit të dërguar mbi këtë problematikë nga ana e IKMT dega Tiranë, rezulton se ky organ nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore, madje nuk arrin të vërtetojë me anë të akteve zyrtare përkatëse, se ka vepruar sipas tyre.

Një gjë është e kuptueshme dhe jashtë logjikës ligjore në këtë rast, nuk mundet që momenti i njoftimit të barazohet me momentin e ekzekutimit të një vendimi për prishje objekti, pasi edhe koncepti i hyrjes në fuqi dhe i sjelljes së pasojave të aktit administrativ, reflekton mundësinë kohore të subjektit me njohjen e përmbajtjes së këtij akti dhe reagimin fillestar për ndjekjen e rrugës së ankimit administrativ apo gjyqësor, ndaj tij.

Kjo mënyrë trajtimi, e cila realisht flet për veprim në kundërshtim me ligjin nga ana e IKMT dega Tiranë, konstaton faktin tjetër se, shtetasit H.K i është përkeqësuar situata konkrete ligjore, duke iu shkelur në këto kushte e drejta themelore për një proces të rregullt ligjor.

Edhe përcaktimi i dhënë në paragrafin e parë, të nenit 14, të Ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Kundër vendimit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe atij të njësisë vendore lejohet ankimi i drejtëpërdrejtë në gjykatë brenda 10 ditëve, duke filluar nga data e njoftimit të vendimit”*, shkon në të njëjtën llogjikë me respektimin e së drejtës së ankuesit për një proces të rregullt ligjor.⁹

Në këtë çështje vërehet se, IKMT Tiranë, nuk arrin të vërtetojë ezaurimin e procedurës së njoftimit zyrtar, të dy akteve dhe përkatësisht të proces verbalit të konstatimit të kundërvajtjes, nr.7 datë 14.09.2017, dhe të Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.29 datë 19.09.2017, ndaj shtetasit H.K.

Ky është rasti kur, kemi të bëjmë me një ndërtim të kundërligjshëm të cilësuar si të tillë nga vendimmarrja paraprake e ALUIZNI-t, dihet identiteti i subjektit kundërvajtës, nuk njihet adresa e saktë aktuale e kundërvajtësit, por gjatë ushtrimit të kompetencave ligjore nga ana e IKMT-së, për konstatimin, sanksionimin me vendimmarrjen përkatëse të ndërtimit të kundërligjshëm dhe njoftimit të akteve të dala subjektit kundërvajtës, për të vazhduar me ekzekutimin e vendimmarrjes respektive, ka dështuar faza e njoftimit efektiv zyrtar të aktit administrativ.

⁹ Fryma dhe logjika e ligjit nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, në përcaktimin e kompetencave dhe afateve procedurale, për konstatimin e ndërtimit të kundërligjshëm, nxjerrjen e vendimit përkatës penalizues për kundërvajtësin, njoftimin e këtij vendimi dhe ekzekutimin e tij, është e tillë që shkon në të njëjtën linjë përputhshmërie me respektimin e së drejtës themelore të individit, për një proces të rregullt ligjor në rrafshin administrativ të shqyrtimit të çështjes.

Ekzekutimi i vendimit të marrë në këtë rast do të duhej të kryhej në përputhje dhe në respektim të të gjitha afateve ligjore të njoftimit, të parashikuara sipas specifikës së çështjes, në nenet 147-163, të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjatë trajtimit të kësaj çështjeje kemi sjellë në vëmendje parimin e përgjegjësisë në veprimtarinë e organeve publike, të parashikuar në nenin 15, të Kodit të Procedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se: *“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktajnë palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi”*.

Mosveprimi i IKMT dega Tiranë, ka rezultuar në kushtet e parashikuara nga Ligji nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar, pasi realisht i është shkaktuar dëm shtetasit H.K, në kushtet e trajtimit të kësaj çështjeje jo në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.¹⁰

Në këto rrethana i kemi rekomanduar Kryeinspektoret së IKMT-së, me anë të shkresës sonë nr.K3/H19-7 datë 23.01.2018;

“Fillimin e procedurës administrative për shpërblimin e dëmit, që i është shkaktuar shtetasit H.K, si pasojë e e ndërhyrjes nga ana e IKMT-së për prishjen e banesës së tij, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar.

* **Në ankesën e tij shtetasi I.K.** shkruan se ka ndërtuar në vitin 1992 një shtëpi në zonën e Shkozës, Tiranë, dhe e ka vetëdeklaruar atë për legalizim në vitin 2005. Ndërkohë në datën 26 Shtator 2017, inspektorë të IKMT-së i kanë njoftuar me anë të një shkrese që do ti prishej shtëpia dhe po në momentin e njoftimit ka filluar puna për prishjen e saj, pa i dhënë mundësinë as për të hequr mobiljet dhe sendet e tjera të përdorimit familjar nga banesa.

Në këtë mënyrë shtëpia e tij u prish dhe ai shprehet se ka ngelur tashmë pa asnjë mundësi strehimi, megjithëse i është drejtuar Bashkisë Tiranë dhe ka aplikuar për trajtim me bonus qeraje.

Në këto kushte, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, për sqarimin dhe zgjidhjen e çështjes së dëmit të shkaktuar ndaj tij në këtë rast.

Nga informacioni i marrë prej Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana Jug dhe IKMT dega Tiranë, na janë vënë në dispozicion këto kopje të shkresave zyrtare, që lidhen me trajtimin e kësaj çështjeje:

¹⁰ Në nenin 3/a, të Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar, ku thuhet se:

“Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktajnë personave fizikë a juridikë private, në rastet që vijojnë:

- *Kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme”.*

1. Shkresa nr.3321 datë 31.08.2017 e Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana Jug, drejtuar z. I.K për dijeni, Kryeinspektorit të IKMT-së, si dhe Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.
2. Urdhëri nr.120 datë 8.09.2017, i Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana Jug, për përjashtimin nga procesi i legalizimit të objektit të vetëdeklaruar me nr.573 prot, datë // 2005, nga z. I.K.
3. Shkresa nr.3321/1 datë 8.09.2017 e Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana Jug, “Njoftim për përjashtim nga procesi i legalizimit”.
4. Vendim për dënim me gjobë nr.14 datë 19.09.2017, ndaj kundërvajtësit I.K.
5. Shkresa e IKMT dega Tiranë, nr.473/3 datë 19.09.2017, “Njoftim vendimi (nr.14 datë 19.09.2017)”, drejtuar shtetasit I.K.
6. Vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.10 datë 19.09.2017, ndaj kundërvajtësit I.K.
7. Shkresa nr.3526/2 datë 19.09.2017 e IKMT Tiranë, “Njoftim vendimi (nr.10 datë 19.09.2017)”, drejtuar shtetasit I.K.
8. Proces verbal (IKMT) ekzekutimi i mbajtur në datë 26.09.2017, për ekzekutimin e vendimit nr.10 datë 19.09.2017, nr.serie 0001420.

Kemi kërkuar në vazhdim të shqyrtimit të kësaj ankese, nga ana e IKMT dega Tiranë, me shkresën tonë nr.K3/I42-7 datë 5.12.2017, sqarimin e procedurës zyrtare të ndjekur me anë të së cilës, shtetasi I.K, ka marrë dijeni për Vendimin për dënim me gjobë nr.14 datë 19.09.2017, dhe Vendimin për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.10 datë 19.09.2017. Më konkretisht kemi kërkuar shpjegime, nëse ato i janë dërguar shtetasit I.K me anë të postës, apo në një rrugë tjetër njoftimi zyrtar. Për këtë gjë kemi kërkuar të na dërgohet edhe një kopje e dokumenteve zyrtare, që vërtetojnë këtë dërgesë në rastin e njoftimit me postë, apo në rast njoftimi me mënyra të tjera ligjore, dërgimin e dokumentacionit respektiv zyrtar, që vërteton ezaurimin e kësaj procedure njoftimi të ndjekur.

Në përgjigjen e IKMT Tiranë dhënë me shkresën nr.4733/A-1 datë 22.12.2017, thuhet se: *“Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit për rastin në fjalë ka bërë njoftimin zyrtar me anë të postës, e cila për shkak të ndryshimit të adresës së qytetarit është kthyer mbrapsht. Në vijim, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, për njoftimin e qytetarit të këtyre akteve, me shkresën nr.665 prot, datë 7.12.2017, me lëndë “Njoftim për shpallje”, i është dërguar Njesisë Administrative nr.1, Bashkia Tiranë, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme”.*

Bashkëngjitur kësaj shkrese janë dërguar edhe një kopje e këtyre dokumenteve zyrtare:

- Shkresa e IKMT dega Tiranë, nr.615 datë 7.12.2017, “Njoftim për shpallje”, sipas përmbajtjes të së cilës, në zbatim të nenit 60, pika “ç”, e Kodit të Procedurave Administrative, i janë dërguar për afishim në vend publik Njesisë Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë, disa vendime për dënim me gjobë, mes të cilëve edhe “Vendim për Dënimin me Gjobë Nr.14 datë 19.09.2017, me nr.serie 0001154, ndaj subjektit I.K.
- Vërtetim zyrtar i Postës Shqiptare, me kod RR 751 228 462 AL, me objekt nr.473/3 (Vendimi i dënimit me gjobë), me shënimin “ka ndryshuar adresë”.

Legjislacioni në fuqi për trajtimin e kësaj çështjeje nga ana e IKMT-së, përcakton shprehimisht:

**Ligji nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar:*

- “Kontrolli i Territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga,
- b) Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit” (neni 3/b).
- “Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet kryeinspektorit dhe inspektorëve, ushtron këto detyra dhe përgjegjësi:
- a) Ushtron përgjegjësitë e veta në nivel njësie vendore drejtëpërdrejt dhe pa asnjë kufizim për ndërtimet/punimet që lidhen me çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor” (neni 9/a).
- Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, përveç detyrave të tjera, të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë që:
- a) Të ushtrorë përgjegjësitë e veta të njësisë vendore, sipas nenit 5, të këtij ligji, për ndërtime/punime të kundërligjshme në territorin e njësisë vendore, që nuk përfshihen në çështje, zona ose objekte me rëndësi kombëtare dhe në territor” (neni 9/1, pika 1/a e plotësuar për zbatimin e saj me parashikimet e pikës 2, 3 dhe 4 të këtij neni).
- “Për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në këtë ligj, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore kryejnë inspektime me një grup inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë, ose me një grup inspektimi të përbashkët, i cili ka në përbërje një inspektor të IKMT-së dhe një inspektor të njësisë vendore.
- Gjendja e konstatuar gjatë kontrollit pasqyrohet në procesverbalin përkatës të konstatimit dhe nënshkruhet si nga kryeinspektori/inspektori që kryen kontrollin, ashtu edhe nga subjekti i kontrolluar ose përfaqësuesi i tij, kur ky është i pranishëm dhe nuk kundërshton të nënshkruajë, një kopje e proces verbalit i jepet subjektit të kontrolluar.
- Kur subjekti i kontrolluar nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin ose nuk është i pranishëm, ky fakt pasqyrohet në proces verbal dhe nënshkruhet nga grupi i inspektimit. Kur subjekti nuk është i pranishëm, i jepet një kopje e proces verbalit brenda 5 ditëve nga data e kontrollit”, (neni 12, pika 1, pika 5 dhe pika 6).
- “Brenda 10 ditëve nga mbajtja e proces verbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë së qeverisjes vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori” (neni 13, paragrafi i parë).

**Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”:*

- “1. Organi publik i komunikon palës ose një subjekti tjetër, të përfshirë në procedurën administrative, veprimin administrativ ose veprimin procedural me anë të njoftimit.
- 2. Në çdo rast, organi publik kryen njoftimin, duke pasur parasysh efektivitetin e tij, mbrojtjen ligjore të interesave të palës, transparencën dhe koston” (neni 147, pika 1 dhe pika 3).
- “Njoftimi publik bëhet në këto raste:

- b. Kur vendi për njoftimin nuk është i njohur dhe njoftimi nuk është i mundur, sipas nenit 151, të këtij Kodi,
- c. kur çdo formë tjetër njoftimi është e papërshtatëshme apo e pamundur” (neni 162, pika 1, gërma “b” dhe “c”.

Sikurse edhe në trajtimin e ankesesës së shtetasit H.K, edhe në këtë rast, analiza kryesore e kryer ka të bëjë me, kohën e njoftimit të aktit administrativ (përkatësisht të dy vendimeve të sipërcituara të nxjerra nga IKMT), si një pjesë shumë e rëndësishme e procedurës ligjore që duhet ndjekur nga ana e organit të administratës publike, për mundësimin e fillimit të efekteve dhe pasojave juridike të aktit administrative.

Në logjikën dhe rregullimet përkatëse të legjislacionit në fuqi, kemi evidentuar se:

-Procedura e ndjekur për njoftimin e Vendimit për dënim me gjobë nr.14 datë 19.09.2017, sikurse rezulton nga dokumentacioni i dërguar nga ana e IKMT dega Tiranë, është në përputhje me parashikimin ligjor të bërë në gërmat “b” dhe ”c”, të nenit 162, të Kodit të Procedurave Administrative, (dhe jo sipas nenit 60, pika “ç”, e Kodit të Procedurave Administrative, të cituar në shkresën e IKMT dega Tiranë, nr.615 datë 7.12.2017).

-Procedura e njoftimit të Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.10 datë 19.09.2017, rezulton jo në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Më konkretisht rezulton se, me shkresën nr.3526/2 datë 19.09.2017, “Njoftim vendimi (nr.10 datë 19.09.2017)”, IKMT Tiranë, ka kryer njoftimin për shtetasin I.K. Kjo formë njoftimi, për nga mënyra e hartimit të përmbajtjes së shkresës nr.3526/2 datë 19.09.2017, nuk përputhet me parashikimet e bëra në nenin 159, të Kodit të Procedurave Administrative, “Dorëzimi personalisht”, dhe rrjedhimisht nuk është në kushtet e këtij njoftimi zyrtar.

Në shkresën nr.3526/2 datë 19.09.2017, përveç faktit se kemi nënshkrimin e kryeinspektorit të IKMT, Tiranë, nuk ka asnjë element tjetër provues procedural, të nevojshëm, që vërteton plotësimin e kërkesave dhe afateve procedurale të dorëzimit personalisht të Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.10 datë 19.09.2017, apo të njoftimit të këtij vendimi në një nga format e tjera, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Ky konstatim përforcohet edhe nga fakti se, nga ana e IKMT-së, nuk na është dërguar asnjë kopje dokumenti zyrtar, që vërteton kryerjen e njoftimit në një mënyrat e tjera ligjore, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Përkundër këtij konstatimi për përmbajtjen e akteve procedurale të njoftimit, kemi pretendimin e shtetasit I.K se, inspektorë të IKMT Tiranë, kanë shkuar dhe i kanë njoftuar vendimin e prishjes së banesës, vetëm para pak se banesa e tij të prishej. Sipas tij, inspektorët e IKMT Tiranë, e kanë bërë fakt prishjen e objektit para se të ezauronin procedurën normale të njoftimit të Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.10 datë 19.09.2017.

Në këto rrethana, barra e provës për njoftimin, e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.10 datë 19.09.2017, bie mbi organin e IKMT-së, ndërkohë që rezulton

se, ky organ nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore, madje nuk arrin të vërtetojë me anë të akteve zyrtare përkatëse se ka vepruar sipas tyre, lidhur me njoftimin e Vendimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm, nr.10 datë 19.09.2017.

Një gjë është e kuptueshme dhe jashtë logjikës ligjore në këtë rast, nuk mundet që momenti i njoftimit të barazohet me momentin e ekzekutimit të një vendimi për prishje objekti, pasi edhe koncepti i hyrjes në fuqi dhe i sjelljes së pasojave të aktit administrativ, reflekton mundësinë kohore të subjektit me njohjen e përmbajtjes së këtij akti dhe reagimin fillestar për ndjekjen e rrugës së ankimit administrativ apo gjyqësor, ndaj tij.

Kjo mënyrë trajtimi, e cila realisht flet për mungesë veprimi nga ana e IKMT Tiranë, konstaton faktin tjetër se, ankuesit i është përkeqësuar situata konkrete ligjore duke ju shkelur e drejta themelore për një proces të rregullt ligjor.

Ekzekutimi i vendimit të marrë në këtë rast do të duhej të kryhej në përputhje dhe respektim të të gjitha afateve ligjore të njoftimit, të parashikuara sipas specifikës së çështjes në nenet 147-163, të Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë trajtimit të kësaj çështjeje kemi sjellë në vëmendje, parimin e përgjegjësisë në veprimtarinë e organeve publike të parashikuara në nenin 15, të Kodit të Procedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se: *“Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi”*.

Mosveprimi i IKMT Tiranë, në kushtet e parashikuara nga Ligji nr.8510 datë 15.07.1999 *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”*, i ndryshuar, i ka shkaktuar realisht dëm ankuesit, në kushtet e trajtimit jo në përputhje me parashikimet ligjore të kësaj çështjeje.

Në këto rrethana i kemi rekomanduar Kryeinspektorese të IKMT-së, me shkresën tonë nr.K3/I42-9 datë 25.01.2018;

“Fillimin e procedurës administrative për shpërblimin e dëmit, që i është shkaktuar shtetasit I.K, si pasojë e ndërhyrjes nga ana e IKMT-së për prishjen e banesës së tij, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar.

Në përgjigjen, e dhënë nga ana e Kryeinspektorit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, me shkresën nr.579/1 datë 31.01.2018, thuhet se çështjet kanë kaluar ndërkohë në shqyrtim gjyqësor, mbi bazën e kërkesë padive të paraqitura nga ana e shtetasve të sipërcituar, ndaj edhe në këto kushte pritet vendimi përfundimtar nga ana e Gjykatës. Ky fakt na është konfirmuar edhe nga ana e shtetasve I.K dhe H.K gjatë takimeve të zhvilluara në vazhdim, në institucionin e Avokatit të Popullit.

3. Me shkresën nr.K3/I39-19 prot, datë 24.10.2017, i jemi drejtuar ARRSH-së, për vënien në dispozicion të kopjes së Vendimit përkatës, për miratimin e Projektit, *“Unaza e Jashtme e Tiranës”*, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve

paralele, segmenti Marteniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës), si dhe të një kopjeje të shkresës nr. 5736 prot, datë 12.07.2017, që ARRSH-ja i ka dërguar IKMT-së. Na është vënë në dispozicion shkresa nr. 5736 prot, datë 12.07.2017, që ARRSH-ja i ka dërguar IKMT-së, por nuk na është dërguar kopja e Vendimit për miratimin e Projektit “*Unaza e Jashtme e Tiranës*”, *Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Marteniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)*. Në vend të këtij vendimi të kërkuar, na është dërguar një kopje e Vendimit nr. 89, të Këshillit Teknik të ARRSH, administruar prej tij me nr.10369 Prot, datë 15.12.2016, me objekt: “*Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa Verilindore (segmenti kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), Loti 3*”.¹¹ Ndodhur në këto kushte është ripërsëritur kërkesa jonë me shkresën nr.K3/I39-25 prot, datë 15.10.2017, drejtuar ARRSH-së. Në vazhdim, ARRSH me shkresën nr.9315/2 datë 30.11.2017, na ka dërguar një kopje të Vendimit të datës 20.02.2013, të Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar, “Mbi shqyrtimin e projekt-zbatimit të objektit “Studim-projektim, Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme të Tiranës, vazhdimi që kalon nga kthesa e Saukut-pjesa lindore, Verilindore, Veriore e Tiranës – deri në afërsi të kthesës së Kamzës (Zyrat e AMC)”.

4. Me shkresën nr.K3/I39-2 prot, datë 19.09.2017, i është kërkuar Bashkisë Tiranë, informacioni, nëse prej strukturave të saj është mundësuar zhvillim procedurash për prishjen e ndërtimeve në zonën e Shkozës, Tiranë; për shpronësimin e tyre; apo për zgjidhjen e problemit të strehimit për familjet, të cilat rrezikojnë të mbeten pa strehë.

Bashkia Tiranë, me shkresën nr.33714/3 datë 18.09.2017, drejtuar IKMT-së, i është përgjigjur Avokatit të Popullit, lidhur me këtë informacion të kërkuar duke vënë në dukje se Bashkia Tiranë, është vënë në dijeni për zhvillimin e procedurave të prishjes së ndërtimeve nga IKMT-ja, me anë të shkresës nr.2897 prot, datë 15.09.2017, të Njesisë Administrative Nr.1, Tiranë. Në këtë situatë Bashkia Tiranë shprehej në shkresë se, “... është duke marrë masat në përputhje me kuadrin ligjor që t’ju vijë në ndihmë këtyre familjeve duke i trajtuar nëpërmjet programeve të strehimit social”.

Pavarësisht mungesës së gjithë informacionit të nevojshëm rreth çështjes së prishjes së ndërtimeve informale në zonën e Shkozës, Tiranë, në zbatim të Projektit “*Unaza e Jashtme e Tiranës*”, *Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Marteniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)*, institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se, veprimtaria e organeve dhe institucioneve shtetërore në këtë trajtim mbart paligjshmëri dhe parregullsi, të cilat konsistojnë në:

¹¹ Në përmbajtjen e Vendimit nr. 89, të Këshillit Teknik të ARRSH, administruar prej tij me nr.10369 Prot, datë 15.12.2016, thuhet shprehimisht se: “Këshilli Teknik i ARRSH-së, i mbledhur në datë 14.12.2016...mori në shqyrtim materialet me propozimet për ndryshime/përmirësime/modifikime/saktësime dhe shtesë punimesh, në projekt – preventivin e objektit “Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa Veri-lindore (segmenti kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), Loti 3. Po kështu në pjesën e dispozitivit të këtij vendimi, në pikën e tij të pare thuhet shprehimisht: “Të miratojë në parim propozimet e kontraktorit të aprovuara nga mbikqyrësi i punimeve për saktësime, ndryshime/modifikime, përmirësime e plotësime të projekt-preventivit, dhe punimet shtesë në objektin “Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa Verilindore (segmenti kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), Loti 3””.

- *Mospërfundimin e procedurës administrative nga ana e ALUIZNI, në afatin ligjor të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, sipas kohës së depozitimit të vetëdeklarimeve për legalizimin e ndërtimeve informale, të kryera prej subjekteve vetëdeklaruese në zonën e Shkozës, Tiranë.*

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e ALUIZNI-t, na rezulton se, poseduesit e ndërtimeve informale të ndodhura në zonën ku po zbatohet Projekti i lartpërmendur, kanë kryer vetëdeklarim për legalizim, në periudha kohore të ndryshme, duke nisur nga viti 2005 e deri më datë 27.06.2014, për ndërtimet informale të kryera prej datës 02.08.1991, e deri në datë 27.06.2014.

Referuar legjislacionit në fuqi (Ligji nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, meqënëse Ligji nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, nuk parashikon afate konkrete), në kohën e kryerjes së vetëdeklarimit konstatohet se, nuk është respektuar afati ligjor brenda të cilit do të duhej të përfundonte procedura administrative prej ALUIZNI-t, me daljen me një vendim përfundimtar për legalizimin e ndërtimit informal të vetëdeklaruar, ose përjashtimin e tij nga procesi i legalizimit.

Në rast se do të zhvillohej procedura administrative brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 49, i Ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe ndodhur në kushtet e mungesës së projektit zhvillimor të zonës ku ndodhen ndërtimet informale, deri në datën e marrjes së vendimit për miratimin e Projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, *Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Marteniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)*, statusi juridik i ndërtimeve në Shkozë, do të ishte i ndryshëm nga ai që paraqitet sot.

Sjellim në vëmendje faktin se, shumica e vetëdeklarimeve të kryera prej subjekteve për ndërtimet informale të ndodhura në Shkozë, datojnë menjëherë pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, dhe VKM-në, nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje”. Me konkretisht, bazuar në informacionin që na është dërguar nga ana e ALUIZNI-t, ka rezultuar se është paraqitur numri i vetëdeklarimeve për legalizim, në vitet respektive, sipas tabelës së mëposhtme:

Viti 2005	Viti 2006	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
31	47	4	11	5	1

Ligji nr.7693, datë 06.04.1993 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, si dhe Ligji Nr. 8405, Datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, kanë parashikuar për organet apo institucionet përgjegjëse, detyrime për kryerje veprimesh, deri në prishjen e objekteve të ndërtuara në mënyrë të kundërligjshme.

Në kushtet e mosveprimit nga ana e këtyre të fundit, deri në kohën e hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, si dhe kryerjes së vetëdeklarimit prej subjektit posedues të ndërtimit informal, IKMT-ja, në zbatim të nenit 23, të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, apo nenit 66, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nuk ka mundur të ushtrojë kompetencat e veta, pa u marrë më parë vendimi nga ana e ALUIZNI-t, për legalizimin ose jo, të ndërtimit informal të vetëdeklaruar.

Megjithëse, Ligji nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, nuk ka të përcaktuar afat kohor për përfundimin e procedurës administrative të nisur me vetëdeklarimin e kryer prej sejcilit individ, përsëri ky afat gjendet në nenin 49, të Ligjit Nr. 8485, Datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Mosrespektimi i kufirit kohor prej 3 muajsh për përfundimin e procedurës administrative, nga momenti i inicimit të saj, për çdo vetëdeklarim të ndërtimit informal, të kryer prej banorëve të zonës së Shkozës, është i dukshëm në çdo rast. Asnjë justifikim nuk na është dhënë prej këtij organi për mosrespektimin e këtij afati procedural ligjor për përfundimin e procedurës administrative edhe nëse do të ekzistonte ndonjë situatë e veçantë, e parashikuar shprehimisht nga ligji.

Sjellim në vëmendje faktin se, çështja e përcaktimit të një afati specifik për fillimin dhe përfundimin e procedurës administrative, të iniciuar mbi bazën e vetëdeklarimeve të kryera nga subjektet e interesuara, prej organit të ALUIZNI-t, është trajtuar nga ana jonë në rekomandimin drejtuar Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe për dijeni Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, me shkresën nr. K3/Th16-2 datë 19.11.2014.

Në shumë ankesa të trajtuara nga ana e Avokatit të Popullit, ka rezultuar se prej vitesh të tëra nga koha e vetëdeklarimit të objektit informal nga ana e subjekteve të interesuar, ALUIZNI nuk ka konkluduar me vendimmarrjen përfundimtare të pritshme, për legalizimin, ose përjashtimin nga procesi i legalizimit, të objekteve informale të vetëdeklaruar.

Efektivisht sikurse edhe në këtë çështje, na rezulton se, aplikime me vetëdeklarim për legalizim të objekteve informale, të ndërtuara pa leje, janë kryer nga subjektet e interesuara, që nga viti 2005 e në vazhdim.

Në të gjitha këto raste bëhet fjalë për fillimin e një procedure administrative të bazuar në rregullimet e një legjislacioni specifik, mbi legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje, e cila pas shumë vitesh ende nuk ka përfunduar me një akt administrativ (*vendim përfundimtar*), të nxjerrë nga ana e ALUIZNI-t. Kjo gjë del më se e qartë në nenin 28, të Ligjit nr.9482 datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ku zyrës përkatëse të ALUIZNI-t, i përcaktohet kompetenca dhe detyrimi njëkohësisht që brenda 30 ditëve nga përfundimi i procedurave administrative, të pajisë subjektin me lejen e legalizimit.

Megjithëse, ligji “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, ka përcaktuar këtë kompetencë të ALUIZNI-t, duke analizuar në mënyrë të kujdesshme dispozitat e tij, vërehet se procesi i legalizimit të një ndërtimi informal, apo edhe i një shtese informale në një objekt me leje ndërtimi, është kompleks dhe përfshin ndërveprimin ligjor të disa organeve të administratës publike.

Sipas parashikimeve në nenin 7 të këtij ligji (*apo edhe në nenin 37 të tij*), legalizimi i ndërtimeve informale dhe i objekteve me leje, me shtesa informale në objekt, inicohet dhe fillon si proces me vetëdeklarimin e subjekteve që disponojnë ndërtime pa leje. Afati i vendosur për kryerjen e këtyre vetëdeklarimeve, fillon 60 ditë nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, pranë zyrës së urbanistikës së njësisë përkatëse. Vetëdeklarimet janë parashikuar si një proces vullnetar me një afat 4 mujor, nga data e fillimit të procesit të parashikuar më sipër.

Në se vetëdeklarimi nuk kryhet brenda afatit 4 mujor (*neni 8*), subjektit të interesuar i humb e drejta e legalizimit, por nëse deklarimi bëhet brenda muajit të tretë dhe të katërt të afatit të përcaktuar për vetëdeklarim, ligji parashikon vendosjen e gjobave për subjektet përkatëse të interesuara. Pavarësisht këtyre parashikimeve të bëra në dispozitat ligjore, mbetet tërësisht e paqartë çdo të ndodhë me ecurinë e procedimeve administrative të filluara rast pas rasti, në se subjektet e interesuara që kanë vetëdeklaruar ndërtime pa leje në muajin e tretë dhe të katërt të afatit të përcaktuar ligjor, nuk paguajnë gjobën e vendosur nga organet e qeverisjes vendore.

Ndërkohë, po t’i referohemi nenit 10, të Ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, ku përcaktohen procedurat dhe afatet për legalizimin e ndërtimeve pa leje, konstatohet se ai përfshin një mori afatesh që duhet të zbatohen për çdo hap të procesit të legalizimit, duke filluar që nga zyrat e urbanistikës së njësisë të qeverisjes vendore; këshillat e qarqeve; KKT-ja; autoritetet vendore të planifikimit; drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit, si dhe agjencitë rajonale të mjedisit. Po sipas ligjit, në rast se zyrat e urbanistikës dhe këshillat e qarqeve nuk ushtrojnë përgjegjësitë e përcaktuara në këtë dispozitë, ALUIZNI merr përsipër ushtrimin e tyre.

Procedura ligjore e procesit vazhdon të specifikohet me kompetenca dhe afate të tjera proceduriale në nenin 11, të ligjit, kur në vazhdim në nenin 13 parashihet edhe pezullimi i procedurave në raste specifike, tashmë duke përfshirë edhe vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave.

E gjithë kjo procedurë ligjore përfundon, në kuptim të nenit 27 të ligjit, me kompletimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për legalizimin e objektit, i cili përmban disa dokumenta të shoqëruara me pagesën e tarifave të shërbimit pranë njësisë të qeverisjes vendore. Vetëm pas kësaj, zyra e ALUIZNI-t, brenda 30 ditëve nga përfundimi i procedurave administrative, sikundër shprehet ligji në nenin 28, pajis subjektin me lejen e legalizimit, parashikim ky që me ndryshime specifike zbatohet edhe për “shtesat pa leje në ndërtime me leje”.

Në fakt, nisur nga afatet proceduriale të vendosura nga ligji “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, është e vështirë të bëhet një përlllogaritje e saktë e një afati konkret kohor, brenda të cilit fillon dhe duhet të mbarojë procedimi administrativ, mbi legalizimin ose jo të një ndërtimi informal, apo të një shtese informale në një objekt me leje ndërtimi.¹² Ky konkluzion përforcohet edhe me shumë nga fakti se, nuk dihet se çdo të ndodhë me afatet e vendimmarrjes nëse personat e interesuar, nuk paguajnë tarifën e shërbimit të ofruara gjatë këtij procesi nga organet e administratës publike, ose nuk paguajnë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga procesi, përfshirë këtu edhe gjobat që mund të vendosen rast pas rasti.

Akoma edhe më e paqartë bëhet gjendja po t’i referohemi nenit 33, të ligjit, ku thuhet se: *“Mosplotësimi nga subjekti i dokumentacionit përkatës, sipas përcaktimeve të ligjit, sjell përjashtimin nga procesi i legalizimit, urbanizimit dhe integrimin të ndërtimeve informale”*. Kur themi që edhe vetë dispozitat ligjore janë të paqarta dhe evazive në këtë rast, kemi parasysh edhe përcaktimin e dhënë në nenin 28 të ligjit, kur thuhet se: *“Zyra përkatëse e ALUIZNI-t, brenda 30 ditëve nga përfundimi i procedurave administrative, pajis subjektin me lejen e legalizimit...”*.

Në referencë të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, koncepti i procedimit administrativ që në këtë problematikë lidhet me aplikimet rast pas rasti për legalizim të një ndërtimi informal, apo të një shtese informale në një objekt me leje ndërtimi, është një proces që inicohet nga një subjekt specifik, vazhdon me procedura administrative nga të cilat nxirren vendime të ndërmjetme administrative dhe përfundon si procedurë administrative, vetëm me daljen e aktit administrativ nga ana e ALUIZNI-t. Pra edhe formulimi i dhënë në nenin 28 të ligjit, nuk ndihmon llogjikën e vendosjes së afateve konkrete përfundimtare për përfundimin e procedimit administrativ, për legalizimin e ndërtimeve informale, apo shtesave informale në objektet me leje ndërtimi.

Duhet kuptuar fakti se, procesi i legalizimit në vetvete është një proces që bazohet në vullnetin e lirë të subjekteve, të cilët megjithëse efektivisht kanë kryer shkelje ligjore, iu është dhënë mundësia të “korigjojnë” atë përmes një procesi ligjor, i cili mbart detyrime dhe të drejta për ata vetë në radhë të parë, dhe për organet përgjegjëse të administratës publike të përfshira në proces.

Mospërcaktimi i afatit maksimal fundor të mbarimit të procedimit administrativ për legalizimin e ndërtimeve informale, apo shtesave informale në objektet me leje ndërtimi, influencohet në gjykimin tonë edhe për faktin e ezksitencës të frymës shumë liberale që nuk kushtëzon taksativisht mospërmbushjen e çdo lloji detyrimi ligjor nga ana e subjekteve të interesuara, me ndërprerjen e procesit të legalizimit.

¹² Një shumatorë aritmetike e të gjitha afateve të vendosura në ligj për të përcaktuar një afat maksimal të procedimit administrativ për trajtimin e një vetëdeklarimi për legalizim, bëhet e pamundur për shkak të mungesës së qartësisë të vetë dispozitave ligjore, si dhe të një procesi kompleks të parashikuar nga ligji, i cili në këtë kuptim dihet që ka një datë fillimi për çdo rast vetëdeklarimi, por nuk dihet se, kur do të ketë afatin përfundimtar të vendimmarrjes nga ana e ALUIZNI-t.

Mos harrojmë se ky proces është i lidhur me një sërë procesesh të tjera shumë të rëndësishme, sikurse ai i kthimit dhe kompensimit të pronës ish pronarëve, regjistrimit të pasurive të paluajtëshme, urbanizimit dhe planifikimit për urbanizim të zonave të banuara etj. Në këto kushte çdo vonesë në procesin e legalizimit, urbanizimit dhe integritimit të ndërtimeve pa leje, është vonesë për gjithë zinxhirin e proceseve të tjera të lidhura me të.

Llogjika e kufijve kohorë të përgjithshëm për përfundimin e një procedimi administrativ jepet shumë e qartë në nenin 49/1, të Ligjit Nr. 8485, Datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,¹³ kur thuhet se:

“Procedimi administrativ përfundon brenda një periudhe kohore prej 3 muajsh, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në ligje të veçanta, ose kur imponohet nga situata të veçanta. Në rastin e situatave të veçanta, procedimi administrative përfundon 3 muaj pas ndërprerjes së situatës, së veçantë”.

Parashikimet e bëra në ligjin “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, justifikojnë përfundimin e procesit të legalizimit brenda një periudhe më të gjatë kohore se sa afati 3 mujor i parashikuar në Kod, por kurrësi nuk mund të justifikojnë mosparashikimin konkret të një afati maksimal tërësor, brenda të cilit duhet të përfundojë gjithë procesi.

Konstatohet pra, se nuk ka një afat taksativ të përcaktuar qartë në ligj, brenda të cilit duhet të përfundojnë procedimet administrative që, lidhen me vendimmarjen për legalizimin e ndërtimeve informale, apo shtesave informale në objektet me leje ndërtimi.

Ky fakt krijon probleme në vet punën e organeve të administratës publike të përfshira në proces, krijon probleme tek subjektet vetëdeklaruese, krijon probleme në shumë procese të tjera ligjore që ndërthuren përgjatë rrugës së tyre me procesin e legalizimeve.

Kjo situatë shpjegon edhe afatet tërësisht të papranueshme prej mëse 13 vitesh, gjatë të cilave subjektet vetëdeklaruese kanë aplikuar për legalizim të ndërtimeve pa leje dhe për të cilat ende nuk ka një vendim përfundimtar, për legalizimin, ose jo të tyre. Zvarritja e konstatuar nxjerr në konkluzionin se kemi të bëjmë me cënim të së drejtës themelore të individëve, për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42/1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në aspektin administrativ të shqyrtimit të çështjes.

Po kështu mungesa e afatit të arsyeshëm për përfundimin e procedurës administrative, nxjerr në konkluzionin se kemi të bëjmë me cënim të parashikimeve të nenit 6, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe rrjedhimisht edhe të nenit 13, të kësaj konvente.

Ky vlerësim analitik, bazohet në parimin kushtetues se, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut, është jo vetëm një e drejtë e individit, por edhe detyrim parësor kushtëzues në veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore.

¹³ Ligji Nr. 8485, Datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është shfuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Për sa më sipër, i kemi rekomanduar shprehimisht Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit:

“Realizimin e iniciativës legislative për përmirësimin e dispozitave të Ligjit nr.9482 datë 3.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar, lidhur me përcaktimin e një afati unik taksativ të përcaktuar qartë brenda të cilit duhet të përfundojnë procedimet administrative që lidhen me vendimarrjen për legalizimin e ndërtimeve informale, apo shtesave informale në objektet me leje ndërtimi, kjo në përputhje me pikën 1, të nenit 81, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”.

Lidhur me këtë rekomandim nuk ka patur një përgjigje nga ana e Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

*Nga ankesat e pranuar për shqyrtim prej Avokatit të Popullit, për ecurinë e procesit të legalizimit të ndërtimeve në zonën e Shkozës, Tiranë, kemi konstatuar gjithashtu se, në disa raste, ALUIZNI ka kryer procedura ligjore deri në lidhje kontrate për kalim pronësie të parcelës ndërtimore, siç është edhe rasti i ankuesit H.L, i cili ka lidhur “Kontratën e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore”, me ALUIZNI-n, Drejtoria Rajonale, Tiranë, (me nr. 3792 Rep, nr.1491 Kol, datë 04.06.2009, redaktuar para Noteres M.SH). Kjo kontratë është lidhur në kushtet e përmbushjes së kriterëve të parashikuara në nenin 39, të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar, dhe paragrafin 1, pika 2, shkronjat “a”, “b”, dhe “dh”, të VKM nr.438, datë 28.06.2006 *“Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar*”. Pesë vjet më vonë, ALUIZNI, me Vendimin Nr.90, Datë 17.11.2014, ka vendosur për përjashtimin nga procesi i legalizimit të objektit informal në posedim të subjektit H.L.

Pra, referuar së njëjtës situatë juridike, për objektin informal të subjektit H.L, janë kryer veprime dhe vendimarrje, të cilat evidentojnë paligjshmëri në trajtimin e kësaj çështjeje. Nga njëra anë lidhet kontrata me subjektin H.L, për kalimin e pronësisë të parcelës ndërtimore, me ALUIZNI-n, Drejtoria Rajonale, Tiranë, nga ana tjetër është marrë Vendimi Nr.90, Datë 17.11.2014, sipas të cilit është vendosur përjashtimi nga procesi i legalizimit të objektit informal, në posedim të tij. Në kushtet kur veprimi juridik, kontrata për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, Nr. 3792 Rep, Nr.1491 Kol, Datë 04.06.2009, është lidhur midis ALUIZNI-t, Drejtoria Rajonale, Tiranë, dhe shtetasit H.L. atëherë kjo parcelë ndërtimore cilësohet e kaluar në pronësi subjektit H.L. Ky subjekt duhej të shpronësohej, ashtu sikurse ka ndodhur me pasuritë (“truall” dhe “pyll”) të shpronësuar sipas VKM nr. 557, datë 27.07.2016 *“Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, prone private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (LOTI 3)”*”.

*Nga kontaktet e marra me disa banorë të zonës së Shkozës, Tiranë, e cila preket nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore, Tiranë (Loti 3), u evidentua fakti, se, për disa parcela ndërtimore është miratuar kalimi në pronësi i tyre subjekteve posedues, konform parashikimeve të VKM Nr.125, Datë 17.02.2010 *“Për miratimin e kalimit në pronësi të disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”*. Edhe pse ky

vendim i Këshillit të Ministrave është në fuqi, zbatimi i tij nuk është kryer deri më sot prej ALUIZNI-t, si organ i ngarkuar për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore në favor të subjekteve posedues të ndërtimeve informale. Në informacionin e dhënë Institucionit të Avokatit të Popullit, nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, nuk është paraqitur asnjë shkak ligjor, i cili do të mund të justifikonte moszbatimin e VKM nr.125 datë 17.02.2010.

Sjellim në vëmendje se në Vendimin e Kolegjeve të Bashkuara, të Gjykatës së Lartë, nr.1 datë 6.01.2009, vlerësohet shprehimisht se:

“Sipas legjislacionit tonë momenti i fitimit të së drejtës së pronësisë për blerësin është në të njëjtën kohë humbje e të drejtës së pronësisë për shitësin, thelbi i fitimit të së drejtës së pronësisë me titull të prejardhur qëndron në faktin se pronari i ri e fiton të drejtën e pronësisë mbi sendin vetëm në qoftë se tjetërsuesi është pronar i tij”,

“Regjistrimi ose transkriptimi i një veprimi juridik nuk është një element i vlefshmërisë së tij (kontratës). Mosregjistrimi i kontratës në regjistrat e pasurive të paluajtëshme nuk e bën kontratën e tjetërsimit të pasurive të paluajtëshme të pavlefshme, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë tek të tretët. Kontrata e cila nuk është e regjistruar është e perfeksionuar dhe e vlefshme dhe ka efektet thelbësore. Me nënshkrimin e kontratës së tjetërsimit të pasurive të paluajtëshme, përfituesi i të drejtave bëhet pronar i pasurisë së paluajtëshme dhe ky legjitimohet të ushtrojë të drejtat e tij përkundrejt të tretëve, përveç tjetërsimit të pasurisë së paluajtëshme në favor të të tretëve”.

Në këtë logjikë juridike, mënyra e trajtimit të disa pasurive të llojit “Truall”, të cilat përfshihen në zonën e Shkozës që preket nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore, Tiranë (Loti 3), dhe që janë parashikuar si parcela ndërtimore për t’u kaluar në pronësi të subjekteve posedues, konform parashikimeve të VKM Nr.125, Datë 17.02.2010, do të duhej të ishte e ndryshme, nga ajo që rezulton.

E gjitha kjo situatë komplekse ndodh kur;

Së pari, Ligji nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, iu ka dhënë mundësi vetëdeklarimi subjekteve të ndryshëm, për legalizim të ndërtimeve informale të ndërtuara në periudha të ndryshme, duke krijuar pritshmëri ligjore të këtyre subjekteve vetëdeklarues ndaj ALUIZNI-t,

Së dyti, Gjykata e Strasburgut ka theksuar në mënyrë konstante në vendimet e saj se, respektimi i së drejtës së strehimit përfshin edhe rastin e godinave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, ose që ju mungon dokumenti i pronësisë, duke theksuar se, sidomos prishja e shtëpive të ndërtuara në këto kushte, përbën një shkelje të së drejtës së poseduesve të tyre për respektimin e jetës private dhe jetës familjare. Gjithashtu theksi duhet të vihet në faktin nëse, prishja e këtyre shtëpive është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, përpara se të vijohet me prishjen e tyre,

Së treti, fillimi i procedurës së legalizimit nga njëra anë për ndërtimet informale, por edhe ekzistenca e tyre për një kohë të gjatë në zona të caktuara urbane, nuk mund të legjitimojë ndërhyrjen e menjëhershme arbitrare të shtetit, bazuar në projekte ndërtimore publike të miratuara në një kohë të mëvonëshme, pasi në fund të fundit kjo situatë është lejuar që të

ekzistojë si e tillë nga vetë shteti, duke implikuar në vazhdim natyrshëm një sërë të drejtash individuale që lidhen me ndërtimin ekzistues, sikurse theksohet në jurisprudencën e Gjykatës së Straburgut.

Së katërti, prishmëria ligjore që iu është dhënë poseduesve të ndërtimeve informale në këto rrethana, duhet të justifikohet në rastin e zbatimit të projekteve të ndërtimit të veprave publike, me një kundërshtim të arsyeshëm në vlerë financiare të ndërtimit respektiv, pa pretenduar që kjo vlerë të jetë e njëjtë me atë të një ndërtimi në kushtet e një prone të ligjshme. Kjo mënyrë vlerësimi kërkon një logjikë të pranuar dhe të pasqyruar konkretisht, në dispozitat e legjisllacionit rregullator në fuqi.

Vlen të thesohet se në kantierin e ndërtimit, subjekti ndërtues që po kryen punimet për zbatimin e Projektit, “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës), nuk ka vendosur tabelën, e cila njofton projektin që po zbatohet, vendimin në bazë të të cilit është miratuar projekti për ndërtim, organin që ka nxjerrë vendimin për miratimin e Projektit, datën për fillimin dhe mbarimin e punimeve, emrin e subjektit e zbatimit të Projektit, etj. Ky fakt është konstatuar edhe nga nëpunësit e Avokatit të Popullit në datë 04.12.2017, gjatë një verifikimi në zonën ku po zbatohet Projekti i lartpërmendur dhe aktualisht kjo gjendje vazhdon të mbetet e njëjtë.

5. Situata e dëbimit me forcë

Në takimet zyrtare që janë zhvilluar nga përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit, me kryeinspektoren e IKMT-së, në datë 20.09.2017, lidhur me këtë problematikë na është pohuar verbalisht se, do të preken nga zbatimi i projektit 169 objekte-ndërtime. Nga këto, 82 objekte janë përjashtuar nga procesi i legalizimit me vendim nga ana e ALUIZNI-t, ndërsa pjesa tjetër mbetet me një status të papërcaktuar (mund të jenë të ligjshme dhe duhen shpronësuar, apo janë të pa vetëdeklaruar).

Në këto rrethana, duke qënë se shumica e objekteve që do të prishen janë banesa të ngritura prej vitesh në këtë zonë, është e kuptueshme që ky zhvillim do të prekë jetën e shumë familjeve të vendosura aty dhe rrjedhimisht edhe të individëve pjestarë të tyre. Në fakt nuk është se është deklaruar një numër i saktë i familjeve që do të preken nga shembja e banesave të tyre, për shkak të ndërtimit të segmentit rrugor “Unaza Lindore Tirane (Loti 3)”, por numri i objekteve që janë prishur tashmë ose që do të prishen, flet për një komunitet banorësh të konsiderueshëm në numër, që duhet të zhvendoset nga kjo zonë për shkak të ndërtimit të një veprave publike.

Nisur nga ky fakt, nëpërmjet shkresave tona nr.K3/M37-4 datë 17.10.2017 dhe nr.K3/M37-5 datë 17.10.2017, i jemi drejtuar respektivisht Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe Bashkisë Tiranë, me dy kërkesa për shpjegime, lidhur me masat papaprake që janë marrë nga ana e këtyre institucioneve për zgjidhjen e kësaj çështjeje, që pretendohet se ka të bëjë efektivisht me një situatë “dëbimi me forcë”, të familjeve që preken në pronësitë e tyre nga zbatimi i projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza Lindore Tirane (Loti III)”.

Sipas kompetencave respektive në trajtimin e kësaj problematike, kemi kërkuar të vihemi në dijeni, nëse ka patur koordinim ndërmjet ARRSH-së dhe Bashkisë Tiranë për këtë çështje dhe nëse është kryer një studim paraprak i gjendjes së familjeve që preken në pronësitë e tyre nga zbatimi i projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza Lindore Tirane (Loti III)”, sa i takon përbërjes së tyre, mundësive financiare, trajtimit të mundshëm me strehim dhe çështjeve të tjera sociale, që lidhen me nivelin e jetesës në vazhdim.

Po kështu, kemi kërkuar shpjegime mbi faktin se si është menduar dhe se si do të zgjidhet problemi i strehimit të këtyre familjeve pas zhvendosjes nga kjo zonë. Informacioni që do të dërgohet nga ana e këtyre institucioneve është kërkuar që të shoqërohet me një kopje të dokumentacionit zyrtar përkatës.



Në përgjigje të kërkesës sonë, ARRSH-ja me anë të shkresës nr.8294/1 datë 26.10.2017, e referon kërkesën tonë shprehimisht si: “...informacion dhe kopje të dokumentacionit zyrtar mbi procedurat e shpronësimit, apo koordinimin me Bashkinë e Tiranës...”, duke na vënë në dispozicion këto dokumente zyrtare:

1. VKM nr.557 datë 27.07.2016 “Për shpronësimin e pronarëve, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza Lindore Tiranë Loti III.
2. Kërkesa për shpronësim, nr.1464 datë 23.02.2017 dhe nr.4218/3 datë 31.08.2017.
3. Korrespondenca e kryer me Bashkinë Tiranë dhe Njësinë Bashkiake, nr.1, Tiranë.
4. Korrespondenca e kryer me ALUIZNI-n dhe IKMT.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur bashkëngjitur kësaj përgjigjeje të ARRSH-së, na rezulton se, VKM nr.557 datë 27.07.2016 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (LOTI III)”, parashikon si subjekte shpronësimi, 30 pasuri të llojit, “Truall” dhe “Pyll”, por jo ndërtime - banesa.

Sa i takon kërkesave për shpronësim që ARRSH-ja, i ka drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, nga dokumentacioni dërguar bashkëngjitur përgjigjes së sipërcituar na rezultojnë se janë paraqitur, kërkesa me nr.4218/3 datë 31.08.2017, kërkesa me nr.4218/4 datë 21.09.2017, si dhe kërkesa me nr.1464 datë 23.02.2017. Nga lista e vetme paraprake që ARRSH-ja ka dërguar bashkëngjitur kërkesave për shpronësim, si dokumentacion për këtë çështje na rezulton se, ***kërkohet shpronësim për subjektet përkatëse për 2 (dy) pronësi të llojit “Arë”, për subjektet përkatëse për 13 (trembëdhjetë) pronësi të llojit “Truall”, për subjektet përkatëse për 29 (njëzet e nëntë) pronësi të llojit “Ndërtesë”, si dhe për subjektet përkatëse për 2 (dy) pronësi të llojit “Apartament”.*** Nëse i referohemi kësaj liste atëherë del e qartë se, vetëm 31 pronësi që mund ti cilësojmë si banesa ku jetojnë familje të këtij komuniteti do të shpronësohen, ndërsa diferenca prej 138 objektsh-ndërtime të tjera (më lart është cituar që kryeinspektorja e IKMT ka deklaruar se, do të preken nga zbatimi i projektit 169 objekte-ndërtime), do të prishen.

Ndërkohë me shkresën nr.4442 datë 1.06.2016, ARRSH-ja njofton Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, se në vijim të “Kërkesës për shpronësim”, nr.1232 prot, datë 25.01.2015, pas afishimit të listës për shpronësim në Fletoren Zyrtare, nuk është paraqitur asnjë ankesë nga ana e pronarëve. Sikurse rezulton pra, kemi të paktën 4 kërkesa për shpronësim të konfirmuara nga ana e vet ARRSH-së, të paraqitura nga viti 2015 e në vazhdim.

Korrespondenca e kryer me Bashkinë Tiranë dhe Njësinë Bashkiake, nr.1, Tiranë, përfshin sipas dokumentacionit dërguar nga ARRSH-ja, shkresën nr.7487/1 datë 3.10.2017, “dërgim dokumentacioni”, Bashkisë Tiranë, ku bëhet fjalë edhe për ekzistencën e ndërtimeve që preken nga zbatimi i Projektit, të konstatuara nga ana e ARRSH-së, që janë ndërtuar para vitit 1991, për të cilat poseduesit nuk disponojnë dokumenta ligjore pronësie, të lëshuara nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, Tiranë. Mbi këtë bazë, Bashkisë Tiranë i është kërkuar vazhdimi i procedurave për regjistrimin e tyre, në përputhje me parashikimet e VKM nr.608 datë 5.09.2012, duke i dërguar këtij institucioni edhe planimetrinë e shpronësimeve në shkallën 1:1000, ku janë evidentuar objektet e sipërpërmendura, listën e poseduesve të tyre, si dhe dokumentacionin e dërguar nga ana e tyre.

Me shkresën nr.7345/1 datë 18.09.2017, ARRSH-ja i ka dërguar dokumentacion Njësisë Bashkiake nr.1, Tiranë, mbi ecurinë e shpronësimeve në segmentin që preket nga zbatimi i Projektit.

Nga korrespondenca e kryer nga ana e ARRSH-së, me ALUIZNI-n dhe IKMT, konstatojmë shkresën nr.5736/4 datë 22.09.2017, ku ARRSH-ja dërgon një kopje të planimetrisë së shpronësimit, një kopje të VKM nr.557 datë 27.07.2016, si dhe listat e pronarëve të përfshirë në kërkesën për shpronësim të dërguar për shqyrtim në Ministri. Me shkresën nr.2308 datë 24.03.2017, ARRSH-ja i kërkon Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana Jug, konfirmim për legjitimitetin e disa pronave të legalizuara nga kjo drejtori. Me shkresën nr.2145/1 datë 7.04.2017, ARRSH-ja i ka dërguar IKMT-së planimetrinë e shpronësimeve, si dhe VKM nr.557 datë 27.07.2016. Ndërkohë, me shkresën nr.4218/3 datë 31.08.2017, ARRSH-ja i ka dërguar Ministrisë së Transportit dhe

Infrastrukturës (Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve), një material ku përfshihet kërkesa për shpronësim, e pasurive të paluajtëshme pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë, Loti III”.

Para përgjigjes së dhënë nga ana e Bashkisë Tiranë me shkresën nr.37973/1 datë 2.11.2017, nga korrespondencat zyrtare që kemi disponuar për trajtimin e kësaj problematike komplekse, kemi konstatuar shkresën nr.33714/3 datë 18.09.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, në Bashkinë Tiranë, drejtuar kryeinspektores së IKMT-së, ku evidentohet marrja dijëni për punimet që po kryhen për zbatimin e Projektit, përmes shkresave nr.2897 datë 15.09.2017 dhe nr.2897/3 datë 18.09.2017, që Bashkisë Tiranë ia ka drejtuar Njësia e saj Administrative nr.1.

Sipas kësaj shkrese, Bashkia Tiranë ka marrë kontakte në vend me familje të komunitetit të banorëve, banesat e të cilëve preken nga zbatimi i Projektit, për njohjen e situatës social-ekonomike të këtyre familjeve. Sipas një vlerësimi fillestar të cituar në shkresë, punësimi i anëtarëve të një pjese të këtyre familjeve, mbulon vetëm nevojat bazë të jetesës dhe jo më shumë. Në këto kushte, Bashkia Tiranë ka kërkuar mirëkuptim dhe bashkëveprim me IKMT-në, për t’ju mundësuar banorëve ndihmë përmes trajtimit me programet sociale të strehimit.

Paraprakisht kemi kërkuar të vihemi në dijeni të faktit, nga ana e Bashkisë Tiranë, nëse ka patur koordinim ndërmjet ARRSH-së dhe Bashkisë Tiranë për këtë çështje dhe nëse është kryer një studim paraprak i gjendjes së familjeve që preken në pronësitë e tyre nga zbatimi i projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza Lindore Tirane (Loti III)”, sa i takon përbërjes së tyre, mundësive financiare, trajtimit të mundshëm me strehim dhe çështjeve të tjera që lidhen me nivelin e jetesës në vazhdim. Gjithashtu, kemi kërkuar të na sqarohet se, si është menduar dhe se si do të zgjidhet problemi i strehimit të këtyre familjeve pas zhvendosjes nga kjo zonë.

Me shkresën nr.37973/1 datë 2.11.2017, nga ana e këtij institucioni jemi informuar se, nga komunikimet që Bashkia Tiranë ka patur me Njësinë Administrative nr.1, (shkresa nr.1464 datë 23.02.2017, nga Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe shkresave nr. prot.3421/2 dhe nr.prot.4703/1 datë 18.09.2017, nga Ministria e Zhvillimit Urban (ALUIZNI), kjo njësi e qeverisjes vendore ka marrë dijëni se, një pjesë e familjeve që preken nga ky investim publik, janë përjashtuar nga procesi i legalizimit, pasi rezultojnë si objekte të ndërtuara pa leje.

Sipas përgjigjes, Bashkia Tiranë ka vlerësuar paraprakisht gjendjen emergjente dhe nevojën për strehim të familjeve të prekura në këtë zonë, duke realizuar vlerësimin social ekonomik në çdo familje. Në vazhdim konfirmohet se, përmes vendimit të Këshillit Bashkiak nr.113 datë 28.09.2017, Bashkia Tiranë u ka ardhur në ndihmë familjeve të prekura nga zbatimi i projektit, me mbulimin e shpenzimeve të qirasë për një periudhë 1 vjeçare. Bashkëngjitur kësaj përgjigjeje na janë dërguar edhe një kopje e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.113 datë 28.09.2017, lista emërore e subjekteve që do të përfshihen në kategoritë e trajtimit me qira sipas këtij vendimi, ku evidentohen emrat e 113 kryefamiljarëve, si dhe një numër prej 71 formularësh, me të dhëna paraprake për familjet

që preken nga ndërtimit të segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë, Loti III”. Në përmbajtjen e këtyre formularëve kërkohen të dhëna që lidhen me tipologjinë e banesës, kohëqëndrimin e familjes në zonë, numrin e fëmijëve në familje dhe sa prej tyre ndjekin arsimin, numrin e të punësuarve në familje, burimet e të ardhurave, gjendja shëndetësore, a kanë aplikuar për programe strehimi në bashki, apo edhe historiku i familjes. Në një pjesë të formularëve koha e plotësimit është data 16.09.2017, ndërsa në disa të tjerë mungon data përkatëse e plotësimit.

Në këto rrethana dhe së paku nga përmbajtja e kësaj shkrese rezulton se, nuk ka patur një komunikim real dhe të nevojshëm, si dhe koordinim paraprak ndërmjet ARRSH-së dhe Bashkisë Tiranë, për trajtimin e familjeve të cilat preken në pronësitë e tyre, pra të banesave, qofshin këto në posedim, apo në pronësi të ligjshme, si pasojë e zbatimit të Projektit.

Minimalisht nga të dhënat që na janë dërguar nga ana e Bashkisë Tiranë, janë 113 familje të vendosura në zonën e Shkozës, të cilat preken në banesat e tyre nga zbatimi i Projektit. Është e vështirë të thuhet një numër i saktë i komunitetit të banorëve që preken në këto rrethana, pasi kjo gjë nuk del e qartë as nga të dhënat e dërguara nga ana e Bashkisë Tiranë, por mund të thuhet me siguri komuniteti ka në përbërje gra, fëmijë dhe pleq, disa prej të cilëve kanë një periudhë prej rreth 27 vitesh që banojnë në banesat që familjet e tyre kanë ndërtuar vetë.

Efektivisht kjo situatë, për shkak të mënyrës se si po veprohet nga ana e ARRSH-së dhe për rrjedhojë edhe nga ana e IKMT-së, paraqitet në kushtet e “dëbimit me forcë”, në shkelje të të gjitha parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të trajtimit të rasteve të dëbimit me forcë. Për të kuptuar gjendjen e krijuar, sjellim në vëmendje parimet dhe standardet ndërkombëtare, mbi bazën e të cilave duhej të trajtohej dhe aktualisht, duhet të trajtohet në vazhdim kjo çështje.

Sipas rekomandimeve të OKB-së dhe interpretimeve të dhëna në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, shteti ka detyrim të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm për të siguruar që të gjithë personat të kenë siguri në zotërim të banesës, pavarësisht disponimit të titullit të pronësisë. Pra, shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore kundër dëbimeve të detyruara, ngacmimeve dhe kërcënimeve të tjera dhe të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Parimet themelore që duhet të reflektohen në masat e domosdoshme që ndërmerren në proceset (procedurat) e dëbimit me forcë dhe janë:

- mosdiskriminimi para ligjit,
- detyrimi i përmbushjes progresive të detyrimit për strehim nga ana e shtetit, duke përdorur burimet maksimale në dispozicion, përpara se të kryhet dëbimi dhe prishja e banesës,
- kërkimi dhe pranimi i ndihmës ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me organizma ndërkombëtarë ose OJF,
- dhënia e prioritetit individëve më të rrezikuar dhe më të marginalizuar,
- krjimi i aksesit të plotë dhe në kohë të përshtatshme për informacion,

- pjesmarrja efektive e komunitetit në bisedime dhe në proceset vendimmarrëse,
- llogaridhënia e autoriteteve përgjegjëse.

Në Komentin e Përgjithshëm nr. 4, për të drejtën për një strehim të përshtatshëm, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përcakton se e drejta për strehim nuk duhet të barazohet me pasjen e një çatie mbi kokë, por ajo duhet parë si një e drejtë për të jetuar diku në siguri, paqe dhe dinjitet. Komiteti i sipërcituar ka përcaktuar se, e drejta për strehim është një e drejtë e shumëanshme, që përbëhet nga shtatë aspekte, të cilat duhen përmbushur në mënyrë që të zbatohet plotësisht:

1. Siguria ligjore e posedimit/zotërimit,
2. Mundësia (shërbimeve, materialeve, dhe infrastrukturës),
3. Përbalueshmëria,
4. Jetueshmëria,
5. Aksesueshmëria
6. Vendndodhja (e cila duhet të lejojë akses në tregun e punës, shëndetësi, arsim, kujdes për fëmijët dhe lehtësira të tjera sociale),
7. Përshtatshmëri kulturore.

Bazuar në këto akte të rëndësishme ndërkombëtare dhe në Komentin e Përgjithshëm nr.7 të Komitetit, Raporteri Special i Kombeve të Bashkuara për Strehimin ka publikuar një numër udhëzimesh të detajuara, të njohura si Parimet dhe “Udhëzimet bazë të Kombeve të Bashkuara” dhe “*Udhëzimet për lirimet bazuar mbi Zhvillimet dhe mbi Zhvendosjen*”. Këto parime dhe udhëzime bëjnë më të qarta detyrimet e shtetit, në rastet e lirimit me forcë të banesave.

Masat që jepen në këto parime dhe udhëzime kanë si qëllim që të ofrojnë orientime të qarta për zyrtarët dhe politikëbërësit për procedurat dhe masat që duhen marrë, për të dhënë sigurinë se lirimi i banesës është bërë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Sipas tyre, lirimi i banesës në kushtet e dëbimit me forcë kalon në tre faza, si vijon:

- a) **Përpara lirimit të banesës:** Bazuar në parimet bazë të Kombeve të Bashkuara, lirimi i banesës duhet të konsiderohet si mjete i fundit dhe pasi janë shqyrtuar të gjitha alternativat. Pra autoritetet publike, kanë barrën për të provuar se, dëbimi është i pashmangshëm për interesa publike. Duhet zhvilluar konsultime të vazhdueshme ku të ftohen të marrin pjesë të gjithë personat e prekur, ndërkohë që autoritetet nxisin pjesëmarrjen e grave. Me qëllim që konsultimet të jenë efektive, autoritetet duhet t’u ofrojnë atyre që preken të gjithë informacionin e nevojshëm, që lidhet me arsyet për lirimin e banesës, oraret e punës që do të kryhet, si dhe dhënien e kohës së nevojshme atyre që preken dhe avokatëve të tyre për të dhënë alternativat, komentet, sugjerimet, për planet e autoriteteve. Rezultati më ideal i këtyre përpjekjeve do të ishte përfundimi i një marrëveshjeje mes autoriteteve shtetërore dhe personave që do të lirojnë banesën, ku rregullohen të gjitha aspektet e lirimit të banesës dhe ofrohen alternativa për strehim.

Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që të garantojnë se grupeve vulnerabël, u duhen ofruar mundësi të përshtatshme për të rregulluar strehimin e tyre dhe mosmarrja në konsideratë e nivelit të tyre të mohimit përgjatë viteve ku hartohen kërkesat e nevojshme për rregullimin e strehimit, mund të çojë në diksriminim të tërthortë.

Kjo është e rëndësishme jo vetëm për t'ju dhënë strehim atyre, por edhe për t'i ofruar sigurinë ligjore shtesë, për sa kohë që shtëpitë e paligjshme janë më shumë subjekt i prishjeve.¹⁴

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, ka theksuar se, prishja e shtëpive të paligjshme mund të jetë rezultat i mungesës së politikave efektive të strehimit. Për pasojë është e papranueshme, për të mos thënë e padrejtë, që të penalizosh ata njerëz që nuk kanë asnjë mbështetje nga shteti dhe që janë munduar të rregullojnë problemet e tyre të strehimit me të gjitha mënyrat që ata mundën, duke ushtruar të drejtën e “vetë-ndihmës”.

Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e saj njeh gjykime të tilla si: Yordanova dhe të tjerë kundër Bullgarisë, apo Liliana Assenova Naidenova dhe të tjerë kundër Bullgarisë, ku theksohet se shkelje e të drejtave të njeriut konsiderohet në këto raste, mungesa e ofrimit të çdo forme alternative të strehimit për Romët dhe familjet e tyre gjatë kohës që u lejua dëbimi, si dhe për faktin se autoritetet kishin lejuar Romët të jetonin atje për shumë vite dhe nuk mund t'i urdhëronin papritur që të largoheshin dhe të ndërprisnin jetën e tyre familjare dhe komunitare që kishin zhvilluar gjatë viteve. Edhe komuniteti i banorëve që preket nga zbatimi i Projektit në zonën e Shkozës, paraqitet në të njëjtat kushte si edhe komunitetet e përmendur në vendimet e sipërcituara të dhëna nga Gjykata e Strasburgut.

- b) **Gjatë lirimit të banesës:** Theksohet se kjo ndodh kur lirimi i banesës është i pashmangshëm dhe ai nuk mund të kryhet kur është mot i keq, gjatë festimeve zyrtare, gjatë natës, ose kur banuesit nuk ndodhen aty. Përdormi i forcës duhet të ndodhë plotësisht në përputhje me parimet bazë të Kombeve të Bashkuara, për përdorimin e forcës.
- c) **Pas lirimit të banesës:** Lirimi i banesës i pashoqëruar me ofrimin e alternativave të strehimit mund të konsiderohet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare vetëm në raste shumë përjashtimore. Në çdo rrethanë tjetër, autoritetet duhet të sigurojnë se ato që janë nxjerrë jashtë, kanë akses ndër të tjera në strehime dhe shtëpi, si dhe në shërbimet shëndetësore, ato të edukimit etj, dhe se lirimi me forcë nuk duhet t'i kthejë ata në të pastrehë. Për më tepër, autoritetet nuk duhet të injorojnë asnjëherë aspektin gjinor dhe duhet gjithmonë të përpiqen që të nxisin pjesëmarrjen e grave në të gjitha procedurat e nevojshme. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar mirëqënies së grave dhe fëmijëve. Autoritetet duhet të monitorojnë dhe ndjekin kushtet sociale dhe shëndetësore të atyre që shpërngulen, veçanërisht në rastet e shpërnguljes së të gjithë komunitetit.

Por çfarë paraqet situata e krijuar, me familjet e vendosura me banim prej disa vitesh, në zonën e Shkozës, në Tiranë? Avokati i Popullit, në këtë këndvështrim konstaton se:

- Zhvendosja – Dëbimi me forcë, po kryhet në mungesë të një komunikimi dhe konsultimi të domosdoshëm, midis ARRSH-së, Bashkisë Tiranë dhe komunitetit të prekur, lidhur me përcaktimin e zgjidhjeve. Në këto kushte mungon informacioni i plotë mbi çfarë i pret këta qytetarë dhe kjo situatë

¹⁴ Ankim kolektiv nr.31/2005, Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve kundër Bullgarisë, vendim themeli miratuar në 18 Tetor 2006.

rrezikon të rëndojë më tej gjendjen e tyre të vështirë sociale, duke krijuar një tjetër problem edhe më të mprehtë social.

- Sikurse del nga mënyra e trajtimit të deritashëm, por edhe nga informacioni që kemi deri më sot, ARRSH-ja, por edhe Bashkia Tiranë nuk ka një plan të mirëmenduar, të mbështetur në një njohje të plotë të tipologjisë së komunitetit, gjendjes të secilës prej familjeve, qoftë në aspektin e aksesit për një strehë të sigurt, aksesit në skemat e mbrojtjes sociale, gjendjen e tyre ekonomike dhe të pasojave që do të vuajë secila prej tyre, në rast dëbimi me forcë nga zona e Shkozës.
- Në këtë rast nuk bëhet fjalë vetëm për të drejtën për strehim, pasi kjo situatë “Dëbimi me forcë” e pastudjuar dhe në mungesë të konsultimit me komunitetin në fjalë, cënon të drejtën e tyre për jetën familjare, si dhe të drejtën e tyre për jetën.
- Dëbimi me forcë i këtyre familjeve është një ngjarje e përsëritur, që është konstatuar tanimë me komunitete të ndryshme banorësh, të vendosura në zona periferike ose jo, në qytetet më të mëdha të vendit. Shumica e këtyre ngjarjeve deri më sot janë zhvilluar në shkelje të të drejtave të komuniteteve përkatëse.
- Dëbimi me forcë i këtij komuniteti banorësh, nuk po kryhet në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare të dëbimeve të detyrueshme; nuk po respektohen detyrimet e parashikuara në akte të rëndësishëm të OKB-së, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Si një çështje me përmasa të aspektit juridik dhe social, kjo situatë duhet të trajtohet në vazhdim duke respektuar të drejtat e komunitetit të banorëve që preket nga zbatimi i Projektit, duke parashtruar zgjidhje konkrete, efektive, të qëndrueshme dhe afatgjata, me qëllim garantimin e një jetesë më të mirë dhe jo përkeqësimin e saj. Alternativat e mundshme që janë ofruar nga ana e Bashkisë Tiranë për strehimin e familjeve që mbeten të pastreha nga ky komunitet, nuk duhet të jenë një zgjidhje e përkohëshme, pasi institucioni i Avokatit të Popullit prej kohësh apelon dhe rekomandon me forcë për zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata, që përmirësojnë realisht kushtet e jetesës së këtyre komuniteteve.

6. Ndërtimet ekzistuese para Gushtit të vitit 1991, në zonën e Shkozës.

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave individuale, që lidhen me këtë problematikë na ka rezultuar se, Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) mbi bazën e konstatimeve të tij paraprake ka mbajtur korrespondencë me Bashkinë Tiranë, sa i takon ekzistencës së ndërtimeve në zonën e Shkozës që janë ndërtuar para vitit 1991 dhe për të cilat, poseduesit nuk disponojnë dokumenta ligjore pronësie.

Më konkretisht, korrespondenca e kryer me Bashkinë Tiranë në këtë rast i referohet shkresës të ARRSH-së nr.7487/1 datë 3.10.2017, dërguar këtij institucioni, ku i kërkohet vazhdimi i procedurave për regjistrimin e këtyre ndërtimeve, në përputhje me

parashikimet e VKM nr.608 datë 5.09.2012. ARRSH-ja për këtë qëllim ka dërguar në Bashkinë Tiranë edhe planimetrinë e shpronësimeve në shkallën 1:1000, ku janë evidentuar objektet e sipërpërmendura, lista e poseduesve të tyre, si dhe dokumentacioni i dërguar nga ana e poseduesve të këtyre ndërtimeve.

Për këtë arsye, kemi kërkuar shpjegime nga ana e Bashkisë Tiranë, lidhur me masat e marra për regjistrimin e këtyre ndërtimeve. Informacioni që do të dërgohej është kërkuar që të shoqërohet me një kopje të dokumentacionit zyrtar përkatës, që vërteton hapat e ndërmarra për këtë rast, numrin e ndërtimeve të regjistruara, duke bashkëngjitur njëkohësisht edhe listën e poseduesve të ndërtimeve të para vitit 1991, që i është dërguar paraprakisht këtij institucioni, nga ana e ARRSH-së.

Bashkia Tiranë na ka informuar me anë të shkresës nr.36284/1 datë 23.11.2017 (drejtuar edhe ARRSH-së për dijeni) se, për 16 subjektet pjesë e listës së ARRSH-së, pret plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga ana e VKM nr.608 datë 5.09.2012, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtëshme. Bashkëngjitur kësaj shkresë të Bashkisë Tiranë, na është dërguar edhe një kopje e shkresës nr.36284/1 datë 13.10.2017, që ky institucion i ka drejtuar ARRSH-së, ku kërkohet plotësimi i dokumentacionit përkatës ligjor që mungon në këtë rast.

Në vazhdim kemi kërkuar shpjegime nga ana e ARRSH-së, mbi masat e marra për plotësimin e dokumentacionit ligjor të munguar, sipas kërkesës së paraqitur nga ana e Bashkisë Tiranë. Këtij informacioni kemi kërkuar t'i bashkëngjitet një kopje e listës së poseduesve të ndërtimeve të para vitit 1991, që i është dërguar paraprakisht nga ana e ARRSH-së, institucionit të Bashkisë Tiranë. Jemi ende në pritje të përgjigjes nga ana e ARRSH-së, megjithëse nga ana e kësaj të fundit janë tejkaluar të gjitha afatet ligjore detyruese të dërgimit të informacionit të kërkuar.

Ndërtimet ekzistuese para datës 10.08.1991, pa dokumente pronësie, duhet t'i nështrohen trajtimit sipas parashikimeve të Vendimit të Këshilli i Ministrave, nr.608 datë 5.09.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të pasurive të paluajtëshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, dhe të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre", i ndryshuar.

Në mungesë të informacionit të nevojshëm sqarues, në rastin e zonës së Shkozës, mund të ndodhemi para faktit kur poseduesit e këtyre objekteve, mund të kenë vetëdeklaruar për legalizim këto ndërtime prej kohësh tek ALUIZNI, ndërkohë që ALUIZNI, mund që për to, të ketë nxjerrë vendime për përjashtimin e tyre nga procesi i legalizimit.

Gjithashtu mund të gjendemi para faktit kur, poseduesit e këtyre ndërtimeve mund të jenë njoftuar tashmë, nga ana e inspektorëve të IKMT-së, për prishjen e tyre. E gjitha kjo situatë do të mund të sqarohet nëse do të ishin dërguar tashmë shpjegimet përkatëse dhe kopja e dokumentacionit të kërkuar, nga ana e ARRSH-së.

**Vendimi nr.608 datë 5.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të pasurive të paluajtëshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, i ndryshuar.*

Qëllimi dhe objekti i efekteve ligjore të këtij VKM-je, mbetet përcaktimi i institucionit të autorizuar dhe i procedurës së kalimit në pronësi të pasurive të paluajtëshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, në rastet kur nuk posedohen akte të fitimit të pronësisë (pika 1).

Sipas pikës 3, të këtij vendimi, institucioni i autorizuar është *bashkia*, ku gjendet pasuria e paluajtëshme. Ky akt normativ përcakton gjithashtu procedurat që duhet të ndiqen nga ana e institucionit të autorizuar, për realizimin e kalimit në pronësi të pasurive të paluajtëshme, sipas përcaktimeve të dhëna.

Për më tepër, ai përcakton kompetenca edhe për organe të tjera administrative, gjatë këtij procesi, sikurse për Këshillin e Qarkut, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, Zyrën Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, Ministrin e Financave, Ministrin e Brendshëm. Në këtë kontekst dhe jo pa qëllim, në pikën 15 të këtij vendimi, përcaktohet se: *“Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, ALUIZNI, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi”.*

Vendimmarrja bazë sipas këtij vendimi, i njihet dhe i ngarkohet institucionit të autorizuar, ndërkohë që ALUIZNI, luan një rol informues për çështje që lidhen me kryerjen e procedurave nga ana e institucionit të autorizuar (pika 6/a).

Mbas hyrjes në fuqi të VKM nr.608 datë 5.09.2012, i ndryshuar, del i qartë fakti se nuk është më fushë juridiksionale e ALUIZNI-t, pjesa e ndërtimeve të ndërtuara deri më 10.08.1991, si dhe e truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, sikurse nuk është kompetencë e ALUIZNI-t zhvillimi i procesit të kalimit të pronësisë për këto prona në favor të subjekteve të interesuara. Juridiksioni dhe kompetenca vendimmarrëse në këto rrethana, i takon organeve të administratës publike, përkatësisht bashkive, ku gjendet pasuria e paluajtëshme.

Trajtimi i këtyre çështjeve, paraqet urgjencë vendimmarrjeje mbi bazën e përkatësisë juridiksionale dhe kompetenciale ligjore, pasi edhe ndryshimet që i janë bërë VKM nr.608 datë 5.09.2012, me VKM nr.133 datë 11.02.2015, i japin përparësi vendimmarrjes nga ana e institucionit të autorizuar, për kalimin e pronësisë të pasurive të paluajtëshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, dhe të truallit funksional të tyre, në rastet kur nuk posedohen akte të fitimit të pronësisë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 1, të këtij vendimi.

Mungesa e juridiksionit, si dhe inkompetenca e trajtimit të këtyre rasteve nga ana e ALUIZNI-t, bën që çdo vendim që mund të jetë marrë nga ana e këtij organi, të jetë në kushtet e një akti administrativ, absolutisht të pavlefshëm, në përputhje me parashikimet

e Kodit të Procedurave Administrative. Vendimet e mundshme të nxjerra në këto rrethana ligjore, për procedura legalizimesh konkrete shkelin në procedurën e nxjerrjes së tyre, parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e administratës publike (neni 9), parimin e bashkëpunimit me personat privatë (neni 13), parimin e përgjegjshmërisë (neni 14), si dhe të drejtën për t'u informuar, parime këto të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Edhe në rastet kur nuk kemi një vendimmarrje përfundimtare është detyrim ligjor i ALUIZNI-t, që të ndërpresë procedurat e mëtejshme të filluara për procesin e legalizimit të këtyre objekteve dhe t'ua përcjellë për trajtim, sipas juridiksionit dhe kompetencës ligjore, bashkive, ku gjendet pasuria e paluajjtëshme.

Kësaj analize i shtohet edhe fakti tjetër që lidhet me, fillimin e procedurës administrative për kalimin e pronësisë së banesave të ankuesve dhe të truallit funksional të tyre, për të cilat nuk posedojnë akte të fitimit të pronësisë, bazuar në përcaktimet e VKM nr.608 datë 5.09.2012, i ndryshuar, pranë Bashkisë Tiranë, nga ana e ARRSH-së. Ky zhvillim procedural ligjor, që lidhet me themelin e çështjes, në përputhje me përcaktimin e dhënë në nenin 66, të Kodit të Procedurave Administrative, pezullon çdo lloj vendimmarrje përfundimtare nga ana e IKMT-së, deri në marrjen e vendimit nga ana e Bashkisë Tiranë, si institucion i autorizuar, në ushtrim të kompetencave të parashikuara në pikën 8, të VKM nr.608 datë 5.09.2012, i ndryshuar.

Vendimmarrja e pritshme nga ana e Bashkisë Tiranë, në këtë rast, është një detyrim ligjor i parashikuar në pikën 8, të VKM nr.608 datë 5.09.2012, i ndryshuar, ku sipas pikës 8.1 të këtij vendimi thuhet shprehimisht se: *“Përjashtimisht, në rastet e realizimit të projekteve, investimeve dhe shpronësimeve për ndërtimin e infrastrukturës publike kombëtare ose vendore, institucioni i autorizuar, kryesisht ose me kërkesë të subjektit të interesuar apo të subjektit që kryen investimin, fillon dhe përfundon brenda 7 ditëve procedurat e miratimit të kalimit të pronësisë”*.

Kjo vendimmarrje mungon sot e kësaj dite, megjithëse Autoritetit Rrugor Shqiptar e ka iniciuar procedurën administrative konkrete, që në kohën kur Bashkia Tiranë ka marrë dijëni për shkresën nr.7487/1 datë 3.10.2017, që i është drejtuar asaj prej ARRSH-së.

Pasuritë e paluajjtëshme, të ndodhura në zonën e Shkozës dhe që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Marteniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës”, të ndërtuara deri më 10.08.1991, dhe truallit funksional i tyre, në rastet kur nuk posedohen akte të fitimit të pronësisë, duhet të kishin kaluar në pronësi të ligjshme të poseduesve të tyre, me qëllim që të arrihej në një proces shpronësimi për to. Sikurse rezulton deri tani, megjithëse ka filluar zbatimi i Projektit, kjo gjë nuk ka ndodhur.

7. Konkluzione përfundimtare:

1. Në kuadër të plotësimit të detyrimeve ligjore dhe institucionale, për dërgimin e informacionit të kërkuar nga ana e Avokatit të Popullit, për sqarimin e procedurave ligjore të ndjekura nga ana e institucioneve dhe organeve përkatëse shtetërore të përfshira në këtë problematikë, vërehet se ka vonesa të pajustificuara, dërgim informacioni jo të saktë dhe dërgim të këtij informacioni jo sipas objektit të kërkesës së drejtuar nga ana jonë. Kjo gjë evidenton mungesë transparence nga ana e këtyre institucioneve dhe organeve shtetërore, si dhe në referencë të parashikimeve të bëra në Ligjin nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, mund të konsiderohet rast pas rasti, si refuzim për bashkëpunim me Avokatin e Popullit.
2. Mungesa e justifikimit qoftë ky i pëligjur ose jo, për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të plotë të kërkuar, në një kohë që në zonë vazhdonin të kryheshin veprime për prishjen e banesave, mund të konsiderohet edhe si bashkëpunim, apo përpjekje, për të fshehur veprime të paligjshme, të pretenduara se janë kryer, nga nëpunës apo punonjës të administratës publike.
3. Shkaku ligjor dhe teknik për krijimin e gjithë problematikave të përmendura në Raport, është zbatimi i projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”. Por po t’i referohemi përmbajtjes së informacionit të disa institucioneve të ndryshme, dërguar Avokatit të Popullit mbi këtë çështje, emërtesa e këtij projekti ndryshon dhe nuk ka një terminologji të unifikuar për emërtesën e tij. Për më tepër, pavarësisht se është kërkuar disa herë zyrtarisht nga ana jonë, se cili është vendimi (akti administrativ) për miratimin e këtij projekti, që ka filluar të zbatohet ndërkohë, organet nuk kanë paraqitur deri më sot, aktin normative apo VKM-në përkatëse. Edhe në se do të supozonim se ky akt ekziston, por nuk na është vënë në dispozicion, fshehja e këtij informacioni na vendos përpara situatës se: **nuk ka një vendim për miratimin e projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”, gjë që sjell pasoja shumë serioze për gjithë ligjshmërinë e procesit në tërësi.**
4. Veprimtaria e ALUIZNI-t, në lidhje me trajtimin e vetëdeklarimeve të subjekteve që kanë ngritur ndërtime informale, në zonën e Shkozës, që preket nga zbatimi i projektit të sipërcituar, ka shkelle ligjore të cilat konsistojnë në:
 - a) Mostrajtimin e vetëdeklarimeve brenda afateve ligjore proceduriale, të përcaktuara nga nenit 49, të Ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Brenda këtyre afateve ALUIZNI duhej të shprehej me një vendim përfundimtar për legalizimin, apo përjashtimin nga legalizimi të ndërtimeve informale të vetëdeklaruar. Ky mosveprim, realisht i ka shkaktuar dëm subjekteve vetëdeklaruese të ndërtimeve informale, në zonën e Shkozës që preket nga

zbatimi i projektit, në kushtet e parashikuara nga Ligji nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar. Po kështu, ky mosveprim ka sjellë pasojën që lidhet me shkeljen e, së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, parimit të sigurisë juridike. Ky mosveprim ka shkaktuar “amulli” në mospërcaktimin e qartë paraprak të statusit juridik të këtyre pronësive, para fillimit të zbatimit të projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”. Për të njëjtat situata, për subjekte të ndryshme, ALUIZNI ka marrë vendime të ndryshme në kohë dhe ka ndërprerë në kundërshtim me ligjin, procedura të cilat kanë kaluar disa faza procedurale të rëndësishme.

- b) ALUIZNI rezulton se ka kryer procedura ligjore, deri në lidhje kontrate për kalim pronësie të parcelës ndërtimore (të ndodhur në zonën ku po zbatohet projekti), në favor të subjekteve vetëdeklarues. Por në mënyrë të kundërligjshme procedura nuk është vazhduar më tej, gjë që ka sjellë pasoja të rënda për subjektin tashmë ligjërish pronar të parcelës ndërtimore, sa i takon vlerësimin të gjendjes juridike të ndërtimit informal të vetëdeklaruar prej tij dhe mospërfshirjes në listën e subjekteve që duhen shpronësuar, për llojin e pasurisë “Truall”.
 - c) Për disa parcela ndërtimore të ndodhura në këtë zonë është miratuar kalimi i tyre në pronësi të subjekteve posedues, që kanë ngritur në to ndërtime informale, konform parashikimeve të VKM Nr.125, Datë 17.02.2010 “Për miratimin e kalimit në pronësi të disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”. Edhe pse ky vendim i Këshillit të Ministrave është në fuqi, zbatimi i tij nuk është kryer deri më sot prej ALUIZNI-t, si organ i ngarkuar për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore në favor të subjekteve posedues të ndërtimeve informale. ALUIZNI ka tejkaluar kompetencat e tij, duke marrë vendime përjashtimi nga procesi i legalizimit, në kundërshtim me VKM e sipërcituar.
5. Veprimtaria e IKMT-së, në këtë çështje shfaqet e fragmentarizuar, jo analizuese dhe jo reaguese, mbi veprimet që i kërkohet që të ndërmarrë, në raport me institucionet e tjera shtetërore. Megjithëse në kemi tashmë informacion për procedurat e mbajtura dhe aktet e nxjerrë për rreth 43 subjekte kundërvajtës, nga ana e IKMT-së, përsëri kjo gjendje është e paqartë për shkaqe që janë cituar si mangësi në veprimtarinë e ALUIZNI-t. Po kështu, sjellim në vëmendje se është pohuar nga ana e Kryenispektoret së IKMT-së, fakti që do të preken nga zbatimi i projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”, 169 objekte-ndërtime. Nga këto, 82 objekte janë përjashtuar nga procesi i legalizimit me vendim nga ana e ALUIZNI-t, ndërsa pjesa tjetër mbetet me një status të papërcaktuar (mund të jenë të ligjshme dhe duhen shpronësuar, apo janë të pa vetëdeklaruar).
 6. Paligjshmëri në veprimtarinë e IKMT-së, është konstatuar edhe në dy ankesa individuale të banorëve në zonën e Shkozës, banesat e të cilëve janë prishur për shkak të zbatimit të projektit. Në këto raste, është evidentuar se nuk janë zbatuar procedurat e njoftimit të vendimmarrjes për prishje të objektit, sipas parashikimeve të Ligjit nr.9780 datë

16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, dhe Kodit të Procedurave Administrative.

7. *Procesi i shpronësimit me subjekt përfitues, Autoritetin Rrugor Shqiptar, shfaqet problematik dhe me shkelje të rënda ligjore. Sikurse konstatohet, për pasuritë që preken nga ky projekt, është miratuar VKM nr.557 datë 27.07.2016 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (loti 3)”. Ndërkohë që është duke u punuar për një “Kërkesë për shpronësim” shtesë, ku janë evidentuar pasuri të tjera që nuk janë përfshirë në VKM e sipërcituar. Edhe nga vet qëndrimi i shprehur prej ARRSH-së, evidentohet se VKM nr.557 datë 27.07.2016, nuk ka gjetur ende zbatim të plotë, pasi nuk janë shpronësuar të gjithë subjektet që janë parashikuar në të.*
8. *VKM nr.557 datë 27.07.2016, nuk përcakton shprehimisht afatin dhe mënyrën e pagimit, për pronarët që shpronësohen, për pronarët e pasurive që zhvlerësohen, për personat e tretë që kompensohen për të drejtat e tyre për shkak të pronësimit. Po kështu, ky vendim nuk përcakton shprehimisht, afatin e fillimit dhe të mbarimit të shpronësimit, si dhe afatin e fillimit dhe të përfundimit të punimeve për projektin dhe investimin, ose për realizimin e qëllimit të shpronësimit. **Duke qenë se sipas ligjit, gjithë sa më sipër janë elementë thelbësorë të VKM-së, mungesa e tyre vë në diskutim vlefshmërinë e gjithë procedurës së shpronësimit.***
9. *Justifikimi i dhënë nga ARRSH, se “pagesat për pronarët që shpronësohen nuk janë kryer ende, pasi ka mungesë fondesh”, është shkelje thelbësore e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, të parashikuara si në Kushtetutë, edhe në legjislacionin për shpronësimet. Duke pasur parasysh faktin se ka zvarritje të procedurave të kompesimit të banorëve për efekt të shpronësimit dhe verifikime të tjera shtesë të pasurive që preken nga zbatimi i projektit, kjo procedurë shpronësimi bëhet e pavlefshme në kuptim të mospërmbushjes së kriterëve, që përcakton ligji për këtë qëllim. Nisur nga ky rast, por edhe nga praktika të tjera të marra në shqyrtim nga ana e Avokatit të Popullit, me objekt shpronësimin për interesa publik, kemi konstatuar se përpara fillimit të procedurave të shpronësimit dhe kompesimit të subjekteve, fillohet me punimet publike, ç’ka përbën cënim të të drejtave të pronësisë së ligjshme të pronarëve.*
10. *Numri i objekteve që janë prishur tashmë, ose që do të prishen, flet për një komunitet banorësh të konsiderueshëm në numër, që duhet të zhvendoset nga kjo zonë për shkak të ndërtimit të një vepre publike. Bazuar në rekomandimet e OKB-së dhe interpretimeve të dhëna në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në Komentin e Përgjithshëm nr. 4, të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, për të drejtën për një strehim të përshtatshëm, dhe veçanërisht në Komentin e Përgjithshëm nr.7 të këtij Komiteti, Raporteri Special i Kombeve të Bashkuara për Strehimin ka publikuar një numër udhëzimesh të detajuara, të njohura si Parimet dhe “Udhëzimet bazë të Kombeve të Bashkuara” dhe “Udhëzimet për lirimet bazuar mbi Zhvillimet dhe mbi Zhvendosjen”. Këto parime dhe udhëzime bëjnë më të qarta detyrimet e shtetit, në rastet e liritimit me forcë të banesave. Për shkak të mënyrës se si po veprohet nga ana e ARRSH-së dhe për rrjedhojë edhe nga ana e IKMT-së, gjendja paraqitet në*

kushtet e “dëbimit me forcë”, në shkelje të të gjitha parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të trajtimit të rasteve të dëbimit me forcë.

- 11. Nuk ka patur një komunikim real dhe të nevojshëm, si dhe koordinim paraprak ndërmjet ARRSH-së dhe Bashkisë Tiranë, si dhe komunitetit përkatës të banorëve, për trajtimin e familjeve të cilat preken në pronësitë e tyre, pra të banesave, qofshin këto në posedim, apo në pronësi të ligjshme, si pasojë e zbatimit të Projektit, për të trajtuar në kornizë ligjore këtë situatë, pavarësisht përpjekjeve të Bashkisë Tiranë për një zgjidhje të përkohëshme të çështjes së strehimit për familjet që ngelen të pastreha.*
- 12. Veç këtyre problematikave rezulton se, ekzistojnë pasuri të paluajjtshme, të ndodhura në zonën e Shkozës dhe që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës”, të ndërtuara para datës 10.08.1991, me truall funksional, për të cilat nuk posedohen akte të fitimit të pronësisë. Pavarësisht këtij fakti këta individë duhet të përfitonin pronësinë për shkak se ndërtimi është i realizuar para kësaj date dhe do të duhej që Bashkia të kishte përmbyllur këtë proces në kohë, sipas detyrimeve të përcaktuara në VKM-në e sipërcituar dhe këto prona duhet të kishin kaluar paraprakisht në pronësi të ligjshme të poseduesve të tyre, me qëllim për të mos shkelur të drejtat e ligjshme të banorëve në këtë situatë faktike juridike.*
- 13. Puna e organeve shtetërore, përkatësisht e ARRSH-së dhe Ministrisë së Infrastrukturës në identifikimin e pasurive që preken nga zbatimi i projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III, është e mangët dhe jo efektive, ndaj ministritë e përfshira në këtë proces duhet të marrin masa për të zbatuar detyrat e ngarkuara nga ligji, për të bërë efektive respektimin e së drejtës së pronës.*
- 14. Nga konstatimet e ecurisë së procesit për zbatimin e projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”, në konkluzion përmbyllës evidentojmë se kemi të bëjmë me një proces ku; mungon bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së organeve dhe institucioneve përkatëse shtetërore, duke e kthyer këtë proces në “kaotik”; vërehen shkelje ligjore që çënojnë të drejta dhe liri të ligjshme të individit; vazhdon gjendja e mosreflektimit ndaj kësaj paligjshmërie, duke përkeqësuar situatën juridike të subjekteve që kanë pronësi në zonën ku po zbatohet projekti i sipërcituar, ndërkohë që nuk dihet se kur do të përfundojë ky projekt.*
- 15. Është e nevojshme marrja e masave ligjore nga ana e organeve kompetente, ndaj personave që kanë shkelur dhe shkelin ligjin në trajtimin e këtyre problematikave dhe që nuk bëjnë efektiv zbatimin e ligjit për procedurat e shpronësimit, për mundësimin e realizimit të projektit, ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (loti 3)”. Avokati i Popullit thekson se mosndeshkueshmëria, apo mosnxjerrja e përgjegjësive për këto situata, i kthen këto çështje në shembuj të shkeljeve sistematike të të Drejtave të Njeriut, pasi punonjësit e administratës shtetërore, që kanë shkelur këto të drejta, nuk janë vënë përpara përgjegjësive.*

16. Avokati i Popullit rekomandon që secili prej institucioneve dhe organeve publike të përmendura në këtë Raport të veçantë, të analizojë me përgjegjësi të gjitha parregullsitë dhe shkeljet ligjore të konstatuara dhe të nisë procedurat e marrjes së masave disiplinore, apo kryerjen e kallëzimeve penale përkatëse, për personat përgjegjës, pas verifikimit dhe dokumentimit të shkeljeve respektive.
17. Duke u nisur nga specifikat e konstatuara gjatë hartimit të këtij raporti, gjykojmë se del nevoja e ndryshimit dhe përmirësimit të legjislacionit, lidhur me parashikimin e një dëmshpërblimi të arsyeshëm për të gjithë subjektet posedues të objekteve informale që preken nga zbatimi i projekteve për ndërtimin e veprave publike. Në këtë grupim duhet të futen ndërtimet informale për të cilat ka filluar procesi i legalizimit, apo edhe ndërtime të tjera informale, të cilat vërtetohet se janë ekzistuese në kohë, para miratimit dhe zbatimit të projekteve për ndërtimin e veprave publike. Dëmshpërblimi i arsyeshëm duhet të konceptohet në kuadër të një procesi shpronësimi specifik në këto raste. Ky konkluzion kërkon sjelljen në kohorencë të parashikimeve, si dhe ndërmarrjen e iniciativës legjislative për ndryshime në Ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe për amendime sqaruese, në Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.
18. E drejta e individëve për t’iu drejtuar Gjykatës, nuk përjashton përgjegjësinë e organeve dhe institucioneve të tjera shtetërore për t’iu garantuar qytetarëve, mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore dhe një trajtim proporcional rast pas rasti.
19. Avokati i Popullit në kuadër të mbrojtjes sa më të mirë të të drejtave dhe lirive të ligjshme të individit, si dhe për një mirëadministrim në veprimtarinë e IKMT-së, shpreh qëndrimin se, projektet madhore janë shumë të rëndësishme për t’u zbatuar, pasi kontribuojnë për zhvillimin e mëtejshëm të vendit. Por është i domosdoshëm respektimi dhe zbatimi rigoroz i kuadrit ligjor në fuqi, i cili ekziston dhe është mjaft i gjerë, si dhe proporcionaliteti lidhur me veprimet që ndërmerren, në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës.

Tiranë, Qershor 2018